

Pikëpamjet e autorit të shprehura në këtë doracak nuk i reflektojnë medoemos pikëpamjet e Agjencionit të Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Ky doracak është financuar nga populli amerikan përmes Agjencionit të SHBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID Kosovë), në kuadër të Programit për Arsimin Themelor (Basic Education Program) të USAID-it të cilin e zbaton Family Health International (FHI 360) në partneritet me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës (MASHT) dhe Qendrën për Arsim të Kosovës (KEC).



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

fhi360
THE SCIENCE OF IMPROVING LIVES

Basic Education Program

VLERËSIMI I LEXIMIT NË KLASAT E HERSHME (A-EGRA)

AUTOR

Jehona Xhaferi

REDAKTOR

David Carroll dhe Arlinda Gashi Bajgora

LEKTOR

Shpetim Elezi

DIZAJNI GRAFIK

projectGRAPHICS

BOTIMI I PARË

Maj, 2014

PËRMBAJTJA

Fjalori i termave kryesorë	6
Tabela e shkurtesave	8
1. Informata të përgjithshme për EGRA-n	9
2. Rezultatet e A-EGRA-s në Kosovë	11
3. Kur të përdoret testi A-EGRA	13
4. Administrimi i A-EGRA-s	15
4.1 Administrimi i EGRA-s në letër dhe tabletë	16
4.2 Udhëzime të përgjithshme për administrimin e EGRA-s	17
4.3 Administrimi i EGRA-s	17
4.4 Gjendja emocionale e nxënësve	17
4.5 Rregullat kryesore për shënimin e rezultateve	18
4.6 Rregullat kryesore për të pyeturit	18
4.7 Shënimi i rregullave për EGRA-n	22
4.8 Rezultatet e nëntesteve në A-EGRA	24
5. Reflektim dhe ide për mësimdhënësit	26
5.1 Nëntesti 1 - Vetëdija tingullore	26
5.2 Nëntesti 2 - Njohja e shkronjave	29
5.3 Nëntesti 3 - Fjalët e njohura-fotografike	31
5.4 Nëntesti 4 - Jofjalët	34
5.5 Nëntesti 5a - Rrjedhshmëria e leximit me zë	36
5.6 Nëntesti 5b - Lexim-kuptimi	39
5.7 Nëntesti 6 - Dëgjim-kuptimi	42
5.8 Nëntesti 7 - Diktimi	44
6. Krijo vetë EGRA-n tënde	45
7. Çfarë thanë mësimdhënësit	46
8. Si ta bëni një hulumtim në veprim duke përdorur A-EGRA-n	53
9. Shembuj të hulumtimeve në veprim me A-EGRA-n	54
10. Standardet për vlerësimin e leximit në klasat e ulëta në gjuhën shqipe (A-EGRA)	60
10.1 Çka është Performancë Adekuatë?	60
10.2 Si vlerësohet performanca?	60
10.3 Standardet për Nën-testet momentale të EGRA-s	61

FJALORI I TERMAVE KRYESORË

Principi alfabetik	Baza e secilit sistem alfabetik të shkrimit (ndryshe nga gjuha kineze dhe japoneze, të cilat përdorin sisteme logografike dhe të rrokjeve). Shkronjat dhe kombinimi i tyre përfaqësojnë tingujt e gjuhës, duke u bazuar në marrëdhënie sistematike dhe të parashikueshme në mes të shkronjave, simboleve dhe fjalëve të thëna.
Vlerësimi për Nxënie (VpN)	VpN-ja, e quajtur edhe vlerësimi formativ, është e integruar në pedagogji. Ajo përfshin përcaktimin e synimeve; marrjen e informatës së shpejtë kthyesë; ofrimin e informatave të menjëhershme nxënësve; vetëvlerësimin; vlerësimin e moshatarëve.
Kurrikula bazë	Kurrikula e re bërthamë e Kosovës. Shkathtësia kryesore e komunikimit në të është leximi bashkë me shkrimin dhe të folurit. Lexuesi i suksesshëm lexon tekstin me zë; diskuton dhe interpreton atë që ka lexuar; identifikon porosinë, ngjarjen dhe personazhet kryesore të tregimit; identifikon konceptin kryesor në shkrimin faktik; zhvillon strategji të lexim-kuptimit.
Deshifrimi	Përdorimi i njohurive të marrëdhënies shkronjë-tingull për t'i shqiptuar saktë fjalët e shkruara. Dekodimi u mundëson fëmijëve t'i shqiptojnë fjalët që nuk i kanë parë të shkruara më parë.
Vlerësimi iagnostifikues (i leximit)	Vlerësimi i nxënësve individualisht, apo grupeve të vogla, për të vlerësuar komponentët specifikë të leximit, për shembull, shkathtësitë e fonetikës, rrjedhshmërinë në të folur, apo fjalorin e fjalëve fotografike dhe identifikimi i nevojave.
Vlerësimi i Leximit në Klasat e Ulëta (EGRA)	Test i leximit për klasat 1-3. Është përpiluar fillimisht në SHBA dhe në gjuhën shqipe është përshtatur nga Basic Education Program (BEP).
Shkrim-leximi	Aftësia për të lexuar dhe shkruar. Shkrimi koherent dhe mendimi kritik për fjalën e shkruar.
Rrjedhshmëria e të lexuarit me zë	Aftësia për të lexuar mirë me zë. Rrjedhshmëria zakonisht përfshin shpejtësinë, saktësinë dhe metrikën.
Tingulli	Njësia e vogël e zërit që mund të bashkohet për të krijuar një rrokje apo fjalë. Tingujt në rrokje ndahen në nisma dhe rima, apo kombinim i të dyjave.
Vetëdija tingullore	Aftësia për të dëgjuar, identifikuar dhe përdorur tingujt që i përbëjnë fjalët e folura, të cilat mund ta ndryshojnë kuptimin.

Fonetika	Lidhja në mes të grafemave (simbolet e shkronjave) dhe tingujve (njësitë e vogla të të folurit). Në mënyrë që të zotërohet fonetika, personi duhet t'i zotërojë shkronjat e alfabetit dhe t'i lidhë ato me tingujt përkatës.
Vetëdija fonologjike	Aty ku vetëdija tingullore ndërlidhet me tingujt individualë, vetëdija fonologjike përfshin edhe aftësinë për të dëgjuar dhe manipuluar me njësi më të mëdha të tingujve, siç janë rrokjet.
Metrika	Leximi me ritëm, theks dhe intonacion që reflekton të folurit e natyrshëm.
Leximi me zë	Teknikë e mësimdhënies përmes së cilës mësimdhënësi ua lexon me zë tekstin nxënësve përmes tre hapave, duke përfshirë diskutimin dhe reflektimin.
Lexim-kuptimi	Qëllimi kryesor i leximit është të kuptohet ajo që lexohet, jo vetëm për t'i kuptuar informatat faktike në tekst, por edhe për të nxjerrë informata në lidhje me tekstin, duke përdorur njohuritë dhe përvojën paraprake.
Rrjedhshmëria e të lexuarit	Rrjedhshmëria në lexim nuk do të thotë se është domosdoshmërisht e njëjtë me rrjedhshmërinë e të lexuarit me zë. Rrjedhshmëria e të lexuarit me zë është aftësia për të lexuar mirë me zë. Dikush mund të jetë lexues i rrjedhshëm në heshtje, por jo edhe gjatë të lexuarit me zë.
Fjalori i fjalëve fotografike	Fjalët që personi mund t'i identifikojë menjëherë, posa t'i shohë të shkruara, pa pasur nevojë për dekodim apo analizë të tyre.
Rrokje	Njësia e gjuhës që përbëhet nga tinguj të pandërprerë. Një fjalë mund të ketë një apo më shumë rrokje. Për shembull, fjala "top" ka një rrokje; fjala "bota" ka dy rrokje. Rrokja mund të përbëhet nga një apo më shumë tinguj.
Arka e thesarit	http://sq.bep-ks.org/thesari/ Një ueb-faqe që përmban burime për mësimdhënës, duke përfshirë artikuj, video, shkarkime dhe vegëza në ueb-faqe të tjera të dobishme.
Basic Education Program i USAID-it (USAID-BEP)	Programi financohet bashkërisht nga USAID-i dhe Qeveria e Kosovës (QK). Nga viti 2010 deri në vitin 2015, Basic Education Program (BEP) i përkrah reformat arsimore të Kosovës dhe ndihmon për t'i zhvilluar shkathtësitë e të rinjve për të pasur sukses në ekonominë globale.
Njohja e fjalëve	Aftësia e lexuesit për t'i njohur saktësisht fjalët e shkruara dhe pa shumë përpjekje, pa pasur nevojë që t'i dekodojë ato.

TABELA E SHKURTESAVE

VpN	Vlerësimi për Nxënie
ViN	Vlerësimi i Nxënies
BEP	Basic Education Program - Programi për Arsimin Themelor
EGRA	Vlerësimi i Leximit në Klasat e Hershme
A-EGRA	Vlerësimi i Leximit në Klasat e Hershme në Gjuhën Shqipe
FHI 360	Family Health International
TIK	Teknologjia Informative dhe e Komunikimit
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
MAShT	Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
PISA	Programi për Vlerësimin Ndërkombëtar të Nxënësve
RPP	Raporti Pyetje – Përgjigje
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë
USAID	United States Agency for International Development – Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar

1. Informata të përgjithshme për EGRA-n

Leximi është shkathtësi thelbësore që mundëson të gjitha format e tjera të mësimi. Nxënësi që nuk lexon mirë deri në fund të klasës së dytë, do të ketë vështirësi edhe në lëndët e tjera. Prandaj, është shumë me rëndësi të monitorohet se si lexojnë nxënësit dhe të vlerësohet nëse kanë arritur nivel të domosdoshëm të shkathtësive të leximit. Testet dhe vlerësimet tradicionale nuk ofrojnë informata të shumta për këtë qëllim. Ato i listojnë nxënësit në bazë të rezultatit të përgjithshëm, por nuk përshkruajnë/shpjegojnë çfarë mund dhe nuk mund të bëjnë për t'iu ndihmuar mësimdhënësve për planifikim më efektiv të mësimdhënies. Ajo që nevojitet është një mjet i thjeshtë që mund të ofrojë për nivelin e nxënësve në komponentë të ndryshëm të leximit gjatë hapave të parë të tyre, si në njohjen e shkronjave të alfabetit, leximin e fjalëve të thjeshta dhe të kuptuarit e fjalive dhe paragrafëve.

Vlerësimi i leximit në klasat e ulëta (EGRA) është një instrument i tillë. Bazuar në hulumtime të shumta dhe mjete e vlerësime ekzistuese të leximit, EGRA nuk është një test i cili ofron një rezultat përfundimtar, por një set i detyrave që vlerësojnë shkathtësi të ndryshme, ku secila vlerësohet ndaras; nuk ekziston një rezultat përfundimtar për EGRA-n. EGRA është test individual. Testimi i një fëmije bëhet për rreth 10-12 minuta. Mësimdhënësi mund të administrojë kombinime të ndryshme të nëntesteve, varësisht nga gjykimi i tij për nevojat e nxënësve. Rezultatet për secilën detyrë mund të kategorizohen në bazë të asaj që zbulohet në lidhje me nevojat e nxënësit, varësisht nëse nxënësi është lexues “i mirë”, po përparon në rrugë të drejtë, apo është “në rrezik” të dështojë gjatë mësimi për të lexuar mirë.

EGRA është hartuar në vitin 2006 dhe që atëherë është përdorur në më shumë se 50 shtete dhe në 70 gjuhë. Kjo strukturë modulare i mundëson EGRA-s fleksibilitet të veçantë. Ajo mund të përshtatet për kërkesat specifike të shumë gjuhëve të ndryshme. Rezultatet e testimit EGRA kanë zbuluar anë të forta dhe të dobëta të mësimdhënies dhe të të nxënit dhe i kanë nxitur politikëbërësit dhe edukatorët të gjejnë zgjidhje për t'i adresuar mangësitë, duke përfshirë zhvillimin e strategjive dhe materialeve të mësimdhënies dhe të të nxënit. Shumë nga këto përpjekje kanë rezultuar me përparim të jashtëzakonshëm të niveleve të leximit.

Vlerësimi i Leximit në Klasat e Ulëta në Gjuhën Shqipe (A-EGRA) u hartua nga Programi për Arsimin Themelor (BEP) i përkrahur nga USAID-i. Materialet e para u hartuan në fillim të vitit 2012. Gjatë kësaj faze u hartuan shtatë nënteste, si:

- a) **Vetëdija tingullore:** Dhjetë fjalë, secila duhet të ndahet në tinguj;
- b) **Njohja e shkronjës/Fonetika:** Njëqind shkronja (të mëdha dhe të vogla) që duhen lexuar me zë;

- c) Leximi i fjalëve të shpeshta/fotografike:** Pesëdhjetë fjalë të shpeshta (fjalori fotografik) që duhen lexuar me zë;
- d) Leximi i jofjalëve:** Pesëdhjetë “jofjalë” që duhen lexuar me zë;
- e) Rrjedhshmëria gjatë leximit me zë (i) dhe Lexim-kuptimi (ii). Nxënësi:**
 - i) e lexon me zë një tekst prej 50-60 fjalësh, për një kohë të kufizuar prej 60 sekondash;
 - ii) përgjigjet në pyetje të niveleve dhe llojeve të ndryshme të të kuptuarit në lidhje me të.
- f) Dëgjim-kuptimi:** Nxënësi dëgjon një tekst të shkurtër, i cili i lexohet me zë; pastaj lidhur me atë tekst u përgjigjet pyetjeve të niveleve të ndryshme;
- g) Diktimi:** Administratori lexon një fjali të shkurtër, të cilën nxënësi e shkruan.

Këto nënteste janë pilotuar në shkolla dhe një grup i mësimit janë trajnuar për t’i përdorur ato. Gjatë verës së vitit 2013, pasi u arrit përvojë e mjaftueshme, një ekip bëri rishikimin e testeve dhe materialeve udhëzuese. I gjithë materiali përbëhet nga:

- a) Gjashtë forma të testeve, tri publike dhe tri të sigurta, duke përfshirë një formë të sigurt që është përdorur gjatë testimit të parë për mbledhjen e të dhënave;
- b) Një pako trajnimi për përdorimin e A-EGRA-s, e akredituar nga MASHT-i, që përfshin udhëzuesin për lehtësues dhe video-shembuj, që mund të përdoren qoftë për trajnim formal, qoftë për zhvillim profesional joformal, me bazë në shkollë;
- c) Standardet e performancës dhe udhëzime për interpretim të rezultateve individuale dhe ide për veprim në bazë të rezultateve; dhe
- d) Një mori materialesh përkrahëse për mësimit dhe vlerësimin e leximit.

Të gjitha këto materiale janë në dispozicion në ueb-faqen e BEP-it:

<http://sq.bep-ks.org/egrash/>

2. Rezultatet e A-EGRA-s në Kosovë

Testi A-EGRA është dëshmuar si mjet i dobishëm për mbledhjen e të dhënave për standardet e leximit në klasat e ulëta dhe për vetëdijesimin e mësimeve për rëndësinë e njohjes së nivelit të leximit të nxënësve të tyre dhe planifikimin e mësimeve në bazë të nevojave të nxënësve. Kjo u demonstrua gjatë qershorit të vitit 2012, kur u përdor njëra nga tri format pilot për testimin e leximit të 800 nxënësve nga 40 shkolla partnere të BEP-it në fund të klasës së dytë. Qëllimi i këtij hulumtimi ishte të vendoset një nivel për arritshmërinë në lexim përmes së cilës të vlerësohet puna e programit në këtë fushë, por edhe të mblidhen informata për nivelet mesatare dhe diversitetin e arritshmërisë për shkathtësi të ndryshme të leximit. Raporti për këtë studim mund të gjendet në <http://sq.bep-ks.org/egrash/>

Në përgjithësi, studimi vërtetoi se nxënësit në Kosovë arrijnë standard të mirë në disa fusha. Për shembull, pothuajse të gjithë nxënësit i mësojnë mirë shkronjat (shih tabelën 1), ndërsa shumica (rreth 75%) kanë aftësi për ta përdorur këtë njohuri për dekodimin e jofjalëve (shih tabelën 2). Por, sipas studimit, ka hapësirë për përmirësim në fushat e tjera. Më e rëndësishmja nga këto është rrjedhshmëria dhe lexim-kuptimi. Në të dyja këto fusha, pothuaj 40% e nxënësve janë “në rrezik” (shih tabelën 3). Këto informata janë shfrytëzuar për hartimin e kursit të leximit nga Programi dhe Doracakut të Leximit. <http://sq.bep-ks.org/thesari/>




Tabela 1. Njohja e shkronjave




Tabela 2. Fjalët e njohura (fotografike) dhe jofjalët




Tabela 3. Rrjedhshmëria dhe lexim-kuptimi

3. Kur të përdoret testi A-EGRA

Testimi me AEGRA merr kohë. Është test individual, i cili merr rreth 10-15 minuta për ta administruar. Kjo nënkupton se është mjaft vështirë të testohen më shumë se 10-12 nxënës në një ditë. Në anën tjetër, është më praktike të testohen dy apo tre nxënës gjatë një dite, për shembull, para apo pas mësimit. Për shkak se nxënësit janë më të lodhur pas përfundimit të mësimit, është mirë që testimi të bëhet para mësimit, përveç në raste kur mësimi fillon herët në mëngjes, atëherë testimi bëhet pas mësimit. Shumica e mësimeve nuk preferojnë t'i testojnë të gjithë nxënësit. Mësimeve i identifikojnë nxënësit "në rrezik" dhe përqendrohen te ta, pasi "nxënësit në rrezik" përfitojnë më së shumti nga testimi me EGRA dhe puna individuale pas testimit.

Zakonisht është e mundur të dallohen lexuesit të cilët janë "në rrezik" përderisa jeni duke bërë vlerësimin e rregullt për nxënie. Lexuesi i cili është në rrezik ka tendencë të paraqesë qasje negative ndaj leximit dhe kryesisht mund të vëreni se u mungojnë shkathtësitë e caktuara të rëndësishme për lexim.

1) Qasja negative ndaj leximit

Normalisht, fëmijët kënaqen duke lexuar dhe duke mësuar për të lexuar. Lexuesit "në rrezik" kanë tendencë të dallohen, pasi vërehet se nuk kanë dëshirë të lexojnë. Lexuesi i cili është "në rrezik" mund:

- a) të hezitojë të marrë pjesë në aktivitete të cilat kanë të bëjnë me leximin;**
- b) të mundohet t'i shmanget leximit duke gjetur arsyetime vetëm për të mos lexuar;**
- c) të shfaqë vetëbesim të ulët; apo**
- d) të deklarojë se leximin nuk e sheh si të vlefshëm.**

Qasjet e këtilla kanë tendencë të bëhen edhe më negative, përderisa fëmija vazhdon të ketë vështirësi me detyrat e leximit.

2) Mungesa e shkathtësive të rëndësishme

Të gjithë fëmijët bëjnë gabime, hamendësojnë gjatë leximit e të tjera si këto. Lexuesit "në rrezik" dallohen pasi bëjnë gabime më shumë se të tjerët, gabime të cilat janë tipike për fëmijë më të vegjël, apo hamendësojnë pothuajse tërë kohën. Lexuesi i cili është "në rrezik" mund:

- a) të lexojë shkronjat apo fjalët mbrapsht, apo t'i ngatërrojë (mbi moshën 8-vjeçare);**
- b) kalojë fjalët shpeshherë, apo t'i lexojë gabimisht;**

- c) të shfaqë lëvizje të shpejta të syve (d.m.th. lëviz shumë shikimin nga lart-poshtë dhe nga njëra anë në anën tjetër të tekstit);**
- d) të hamendësojë shumë dhe të heqë dorë lehtë;**
- e) të përdorë gabimisht strategji të caktuara – për shembull:**
- i) vazhdimisht deshifron dhe i lexon fjalët me zë, të cilat do të duhej të jenë në fjalorin fotografik të tij;**
 - ii) hamendëson fjalët e panjohura duke u bazuar në shkronjën e parë dhe të fundit dhe formën e përgjithshme të fjalës, në vend se ta deshifrojë;**
 - iii) hamendëson kuptimin e fjalëve të panjohura në vend se ta shfrytëzojë kontekstin për t'i kuptuar;**
- f) të lexojë rrjedhshëm vetëm kur lexon nga kujtesa, apo një tekst të cilin e ka shumë të njohur; dhe**
- g) të ketë tendencë të bëjë shumë gabime kur lexon me zë (d.m.th. saktësia është e dobët).**

Nëse fëmija në klasën tuaj paraqet disa nga këto karakteristika, atëherë mund ta vlerësoni duke e përdorur testin A-EGRA, për t'i identifikuar në detaje nevojat e tij të të nxënit.

Nëse vendosni ta përdorni testin EGRA, duhet të keni parasysh se për këtë ju nevojitet kohë dhe hapësirë. Me këtë nënkuptojmë se secili nxënës testohet në mënyrë individuale, andaj edhe ju duhet të llogaritni rreth 15 min. për një nxënës. Preferohet që kjo kohë të jetë para orarit të rregullt të mësimit, në mënyrë që të evitohen rezultatet e ulëta si pasojë e lodhjes. Gjithashtu ju nevojitet një hapësirë e ndarë, e qetë, e ndriçuar, ku nuk ju pengon askush. Si ju, ashtu edhe nxënësi, duhet të ndiheni rehat dhe pa shpërqendrim të panevojshme.

Instrumenti EGRA është përpiluar për testim në fund të klasës së dytë. Megjithatë, duke pasur parasysh se është i ndarë në nënteste dhe këto nënteste funksionojnë shumë mirë edhe në mënyrë individuale, ju mund ta përdorni që nga klasa e parë e deri në fund të klasës së dytë. Madje, për raste të veçanta, testi mund të përdoret edhe në klasë të tretë. Në klasën e parë kryesisht përdoren nëntestet 1, 2, 3, 4 dhe 6, d.m.th. vetëdija tingullore, njohja e shkronjave, leximi i fjalëve fotografike, leximi i jofjalëve dhe dëgjim-kuptimi. Në klasën e dytë përdoret i tërë testi EGRA, qoftë si nënteste të ndara apo edhe si tërësi. Ndërsa, në klasën e tretë, kryesisht përdoren nëntestet 5a, 5b dhe 6 (rrjedhshmëria, lexim-kuptimi dhe dëgjim-kuptimi), ndërsa në raste të veçanta përdoren edhe nëntestet 3 dhe 4 (leximi i fjalëve fotografike dhe leximi i jofjalëve). Sidoqoftë, e gjitha varet nga niveli i nxënësit dhe gjykimi i juaj. Asgjë nuk e ndalon përdorimin e p.sh. nëntestit 1 (vetëdija tingullore), në klasën e tretë, nëse vëreni se nxënësi mund të ketë probleme me njohjen e tingujve.

4. Administrimi i A-EGRA-s

EGRA është një qasje dhe metodë e pavarur e vlerësimit të nivelit të leximit. Prandaj, ajo zhvillohet përmes një procesi/instrumenti të rëndësishëm të matjes së nivelit të leximit.

Një ndër arsyet e aplikimit të dëndur të EGRA-s është fuqia e saj për zhvillimin e hulumtimeve në lexim dhe zhvillim të njohjes. Përmirësimi i leximit në klasat e hershme mund të ketë rëndësi të madhe për rritjen e cilësisë në arsim.

Hulumtimet e EGRA-s, sipas një paneli kombëtar për lexim në SHBA, janë të përqendruara në 5 komponentë të cilët konsiderohen thelbësorë gjatë të nxënimit të leximit: fonetika (si lidhen shkronjat me tinguj), vetëdija tingullore (ndarja e tingujve/fonemave në fjalë), fjalori (fjalët e shpeshta), rrjedhshmëria (me zë) dhe të kuptuarit (gjatë leximit dhe dëgjimit).

Këta pesë komponentë strukturorë të leximit shpesh organizohen në më shumë pika. Në modelin e EGRA-s në gjuhën shqipe, këto principe i kemi shtrirë në 7 pika:

- 1. Vetëdija tingullore;**
- 2. Njohja e shkronjës;**
- 3. Leximi i fjalëve të njohura (fotografike);**
- 4. Leximi i jofjalëve (deshifrimi);**
- 5a. Rrjedhshmëria e leximit me zë;**
- 5b. Lexim-kuptimi;**
- 6. Dëgjim-kuptimi;**
- 7. Diktimi.**

Por EGRA nuk mund t'í plotësojë të gjitha kërkesat për mësimin e leximit, të cilat lidhen edhe me metoda mësimore e procese të gjera arsimimi. EGRA është e dizajnuar si një masë e thjeshtë diagnostifikimi.

Qëllimi i EGRA-s është ta dokumentojë performancën e nxënësve në klasat e hershme në fushën e leximit, në mënyrë që të informojë mësimdhënësit, udhëheqësit dhe politikëbërësit për nivelin e arritshmërisë dhe nevojat për përmirësim. EGRA nënkupton trekëndëshin IDENTIFIKIM-INTERVENIM-MONITORIM. Ajo duhet t'u ofrohet si shembull edhe mësuesve për përmirësim të leximit, aty ku shihet e nevojshme. Pra, EGRA ofron udhëzime për mësuesit.

Po ashtu, EGRA nuk është menduar si instrument që duhet të përdoret për vlerësimin e nxënësve për të kaluar ose jo klasën; ajo nuk mund të shërbejë si kërkim llogaridhënieje, për

dënime apo ndëshkime. Është vetëm instrument diagnostifikimi që ofron të dhëna lidhur me shkathtësitë e nxënësit në lexim dhe mbi këto të dhëna nxjerr sugjerime. Për EGRA-n nuk ka rëndësi mënyra (metodat etj.) se si është realizuar një nivel leximi, por matja e tij.

EGRA mund të administrohet në një shkallë më të madhe nga mbikëqyrësit e terrenit të MASHT-it, ose komunave dhe rezultatet të raportohen në shkolla, në komuna dhe në MASHT. EGRA gjithashtu mund të administrohet si një test shqyrtues, nga një mësimdhënës ose psikolog që ka kryer në mënyrë të suksesshme trajnimin e EGRA-s, akredituar nga MASHT-i, mbi administrimin, shënimin e rezultateve dhe interpretimin e EGRA-s.

4.1 Administrimi i EGRA-s në letër dhe tabletë

EGRA është një test individual. Secili nxënës testohet veçmas në një ambient të ndarë. Për të testuar një fëmijë (nxënës) nevojiten përafërsisht 10-15 minuta.

Testimi me EGRA mund të bëhet me fletë apo me tabletë. Programi i BEP-it e ka përpiluar testin në letër, si edhe programin për tabletë, duke përdorur sistemin android.

Të dyja mundësitë janë përdorur nga programi BEP dhe të dyja kanë treguar rezultat. Sidoqoftë, nga bisedat me mësimdhënës, e kemi parë se testimi përmes tableteve është më i përshtatshëm; merr më pak kohë; është më i këndshëm për nxënës pasi që përdor teknologji dhe, në anën tjetër, përpunimi i rezultateve është më i lehtë.

Një gjë duhet pas parasysh te testimi përmes tabletit, në nën-testin 6 – Diktimi, administratori duhet ta shkruajë fjalinë në tablet saktësisht siç e ka shkruar nxënësi, duke mos ia përmirësuar gabimet. Për më shumë informata rreth udhëzimeve shih <http://sq.bep-ks.org/egrash/>

Testi në letër përbëhet nga tri pjesë:

- nga udhëzuesi për administratorë, në të cilin jepen udhëzimet për administrim dhe shënim të rezultateve;
- një komplet të fletëve të plastifikuara që t'i lexojë nxënësi; dhe
- një fletë individuale për shënimin e rezultateve për secilin nxënës që hyn në test, e cila plotësohet nga personi që e administron testin.

Ndërsa testi në tabletë përbëhet nga:

- programi në tabletë, i cili përfshin udhëzimet për administrim, kohëmatësin dhe shënimin e rezultateve;
- një komplet të fletëve të plastifikuara, që nxënësi t'i lexojë.

Kështu, nëse keni tabletë që përdor sistemin android, ju mund të kërkoni nga programi BEP që ta shkarkoni njërin nga tri format e testit A-EGRA.

4.2 Udhëzime të përgjithshme për administrimin e EGRA-s

- **Përputhja në administrim është thelbësore.**
- Udhëzimet dhe rregullat e administrimit duhet të ndiqen me saktësi;
- Të dhënat duhet të regjistrohen **të sakta** dhe **komplete** – mungesa e të dhënave do të thotë përpjekje e kotë.

4.3 Administrimi i EGRA-s

- **Rregulla 3-sekonëdshe:** Nëse nxënësi heziton të përgjigjet për më shumë se tre sekonda në një detyrë të dhënë, atëherë vendoset një shenjë (/) te detyra (shkronja ose fjala) për ta shënuar si të pasaktë. Nxënësi drejtohet te detyra tjetër dhe i kërkohet të vazhdojë.
- **Rregulla e ndaljes së parakohshme:** Nëse nxënësi nuk mund të japë një përgjigje të saktë në ndonjë detyrë në rreshtin e parë, ose në pjesën e nëndetyrës, atëherë ai/ajo falënderohet, shënohet në fletën e rezultateve dhe vazhdohet me nëntestin e radhës. Duhet pasur kujdes që nxënësi të mos ndihet keq në këtë rast. Nxënësi falënderohet me buzëqeshje, në mënyrë që të kujtojë se çdo gjë është në rregull. Nuk duhet të harrojmë se ky nuk është test vlerësues me notë, por është test diagnostifikues.
- **Kohëmatësit dhe kllapat:** Kohëmatësi aktivizohet atëherë kur nxënësi fillon të lexojë shkronjën/fjalën e parë, ose, duke përdorur rregullën 3-sekonëdshe. Me të përfunduar, shënohet një shenjë te shkronja/fjala e fundit që ka lexuar dhe sekondat që kanë kaluar.

4.4 Gjendja emocionale e nxënësve

Të gjithë e dimë se gjendja emocionale e nxënësit gjatë testimit ndikon shumë në rezultat. Duke pasur parasysh se EGRA nuk është vlerësim i nxënies, apo testim me notë, ky fakt bëhet edhe më i rëndësishëm. Në mënyrë që të arrihen rezultate sa më objektive që e udhëzojnë mësimdhënësin për hapat në vijim, gjatë testimit me EGRA duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë gjendjes emocionale të nxënësit. Nxënësit duhet t'i bëhet me dije se ky nuk është testim me notë dhe se, nëse nuk e di ndonjë përgjigje, nuk duhet të shqetësohet. Në këtë rast, qëndrimi dhe toni i zërit të mësimdhënësit/administruesit luan rol të madh.

Sidoqoftë, nëse edhe pas të gjitha përpjekjeve për ta bërë nxënësin të ndihet rehat, ai/ajo megjithatë ndihet i/e shqetësuar, atëherë duhet **ndërprerë testimin**. Testimi mund të organizohet ndonjë ditë tjetër. Ndërkohë që duhet të bisedohet me nxënësin që të mos shqetësohet.

4.5 Rregullat kryesore për shënimin e rezultateve

- **Rregulla e shkronjave/fjalëve të kaluara** - Nëse nxënësi e kalon një shkronjë ose fjalë, atëherë i tregohet shkronja ose fjala, vendoset një shenjë (/) në shkronjë/tingull, i tregohet detyra tjetër dhe i kërkohet “të vazhdojë”;
- **Përgjigjet e gabuara dhe ato të lëna jashtë** - Në rastet kur nxënësi jep përgjigjen e gabuar apo e kalon një shkronjë/fjalë, atëherë vendoset një shenjë (/) në fjalët dhe shkronjat e gabuara;
- **Rreshtat e lënë** - Nëse nxënësi e kalon një rresht të tërë të shkronjave ose fjalëve, atëherë vendoset një vijë nëpër rreshtin e fjalëve ose shkronjave të kaluara dhe merret e pasaktë;
- **Vetëkorrigjimet** - Nëse nxënësi vetëkorrigjohet brenda 3 sekondash, atëherë shkronja/fjala qarkohet dhe shënohet si e saktë;
- **Kllapat** - Kur nxënësi ndalon leximin (ose i kërkohet të ndalet, sepse kanë kaluar 60 sekonda), atëherë vendoset një kllapë pas fjalës së fundit të lexuar.

4.6 Rregullat kryesore për të pyeturit

- Përsëritja e pyetjeve - Nëse nxënësi kërkon që një pyetje të përsëritet, ose nuk e kupton, atëherë ajo i përsëritet vetëm NJË HERË;
- Pyetjet e të kuptuarit - Nxënësit i parashtrohen vetëm pyetjet që kanë të bëjnë me pjesën e tekstit që ai ka arritur të lexojë. NUK parashtrohen pyetjet në lidhje me tekstin që nxënësi nuk e ka lexuar.

1. Vetëdija tingullore

- Ky ushtrim **NUK** është i matur me kohë dhe **NXËNËSI NUK KA FLETË PËRPARA**;
- Duhet pasur kujdes që *tingujt (shkronjat)* të lexohen “pastër”: /p/, jo “pi”, ose “pe”;
- Çdo fjalë shqiptohet **DY HERË** dhe ngadalë (pothuaj 1 fjalë për sekondë);
- Për çdo tingull të pasaktë vendoset një shenjë (/) dhe, po ashtu, për çdo tingull të cilit nxënësi i është shmangur apo e ka kaluar;
- Nëse nxënësi nuk ka përgjigje për një fjalë brenda 3 sekondash, atëherë të gjithë tingujt e fjalës shënohen si gabim dhe vazhdohet më tutje;
- Vetëkorrigjimi llogaritet **si i saktë**;
- Nëse nxënësi nuk jep përgjigje të saktë për 5 fjalët e para, atëherë ai falënderohet, ndërpritet ushtrimi, shënohet në fletën e rezultateve dhe vazhdohet me ushtrimin tjetër;

- Pasi nxënësi të ketë përfunduar, plotësohet fleta e rezultateve. Numërohet dhe shënohet:
 - Numri i fjalëve që nxënësi ka kaluar;
 - Numri i gabimeve që nxënësi ka bërë; dhe
 - Koha e kaluar me sekonda.

2. Njohja e shkronjës

- Gjatë këtij testi, nxënësve duhet t'u kërkohe të thonë emrat (tingujt) e shkronjave të shënuara brenda 1 minute;
- Ky është test i matur me kohë;
- Kohëmatësi aktivizohet në momentin kur nxënësi lexon shkronjën e parë;
- Ndiqen shkronjat ez tjera në rresht, me laps, në fletën e rezultateve. **NUK** ndiqen shkronjat në fletën e nxënësit; nuk tregohet me gisht në fletën e nxënësit;
- Shënohen **gartë** shkronjat e gabuara me një shenjë (/);
- Vetëkorrigjimi llogaritet **si i saktë**;
- Gjatë kohës kur nxënësi përgjigjet, administratori rri i heshtur, përveç nëse nxënësi heziton për 3 sekonda;
- Nëse nxënësi e ka kaluar një rresht me shkronja, shënohet një vijë e gjatë mbi atë rresht;
- Pas 60 sekondash nxënësit i kërkohe të ndalet dhe shënohet shkronja e fundit që ka lexuar;
- Nëse nxënësi nuk ka dhënë asnjë përgjigje të saktë në rreshtin e parë, atëherë falënderohet, ndërpritet ushtrimi, shënohet në fletën e rezultateve dhe vazhdohe me ushtrimin tjetër;
- Pasi nxënësi të ketë përfunduar, plotësohet fleta e rezultateve. Numërohet dhe shënohet:
 - Numri i shkronjave që nxënësi ka lexuar;
 - Numri i gabimeve që nxënësi ka bërë; dhe Koha e kaluar në sekonda.

3. Leximi i fjalëve të njohura/fotografike

- Gjatë këtij testi, nxënësi duhet të lexojë sa më shumë fjalë që mundet gjatë një periudhe njëminutëshe;
- Ky test matet me kohë;
- Kohëmatësi aktivizohet në çastin kur nxënësi lexon fjalën e parë;
- Ndiqen fjalët e tjera në rresht, me laps, në fletën e rezultateve. **NUK** ndiqen fjalët në fletën e nxënësit; nuk tregohet me gisht në fletën e nxënësit;
- Shënohen **qartë** fjalët e gabuara me një shenjë (/);
- Vetëkorrigjimi llogaritet **si i saktë**;
- Gjatë kohës kur nxënësi përgjigjet, administratori rri i heshtur, përveç nëse nxënësi heziton për 3 sekonda;
- Nëse nxënësi e ka kaluar një rresht me fjalë, shënohet një vijë e gjatë mbi atë rresht;
- Pas 60 sekondash nxënësit i kërkohet të ndalet (në mënyrë të butë dhe me buzëqeshje) dhe shënohet fjala e fundit që ka lexuar;
- Nëse nxënësi nuk ka dhënë asnjë përgjigje të saktë në rreshtin e parë, atëherë falënderohet, ndërpritet ushtrimi, shënohet në fletën e rezultateve dhe vazhdohet me ushtrimin tjetër;
- Pasi nxënësi të ketë përfunduar, plotësohet fleta e rezultateve. Numërohet dhe shënohet:
 - Numri i fjalëve që nxënësi ka lexuar;
 - Numri i gabimeve që nxënësi ka bërë; dhe Koha e kaluar në sekonda.

4. Leximi i jofjalëve

- Vlejnë të njëjtat rregulla si te nëntesti 3 - Leximi i fjalëve të njohura/fotografike

5a. Rrjedhshmëria e leximit me zë

- Gjatë këtij testi, nxënësi duhet të lexojë me korrektësi tekstin gjatë një periudhe njëminutëshe;
- Ky test matet me kohë;
- Kohëmatësi aktivizohet në çastin kur nxënësi lexon fjalën e parë.

- Ndiqen fjalët e tjera në rresht, me laps, në fletën e rezultateve. **NUK** ndiqen fjalët në fletën e nxënësit; nuk tregohet me gisht në fletën e nxënësit;
- Shënohen **gartë** fjalët e gabuara me një shenjë (/);
- Vetëkorrigjimi llogaritet **si i saktë**;
- Gjatë kohës kur nxënësi përgjigjet, administratori rri i heshtur, përveç nëse nxënësi heziton për 3 sekonda, ku i tregohet fjala, shënohet si e pasaktë dhe i kërkohet të vazhdojë. Kjo praktikë vazhdohet derisa nxënësi ta mbarojë leximin e tërë tregimit;
- Nëse nxënësi nuk mbaron leximin brenda 60 sekondash, atëherë i kërkohet të ndalojë dhe shënohet një kllapë (|) pas fjalës së fundit të lexuar;
- Nëse nxënësi e ka lexuar gabimisht rreshtin e parë, atëherë i kërkohet të ndalojë dhe vazhdohet me nëntestin tjetër;
- Pasi nxënësi të ketë përfunduar, plotësohet fleta e rezultateve. Numërohet dhe shënohet:
 - Numri i fjalëve që nxënësi ka lexuar;
 - Numri i gabimeve që nxënësi ka bërë; dhe
 - Koha e kaluar në sekonda.

5b. Lexim-kuptimi

- Pasi nxënësi të përfundojë leximin, largohet teksti dhe i parashtrohen pyetjet me radhë;
- Gjatë këtij testi, nxënësi duhet t'u përgjigjet pyetjeve lidhur me tekstin që sapo ka lexuar!
- Nxënësit i parashtrohen pyetjet deri në pjesën ku ka arritur të lexojë.
- Nëse nxënësi nuk arrin të lexojë tërë tekstin, atëherë **NUK** i parashtrohen pyetje për pjesën e palexuar të tekstit;
- Pyetjet lexohen saktësisht siç janë të shkruara dhe nuk sqarohen më tutje;
- Nëse nxënësi kërkon, pyetja mund të përsëritet vetëm një herë;
- Nxënësit i lihet kohë deri në 10 sekonda për ta filluar përgjigjen;

6. Dëgjim-kuptimi

- Ky ushtrim NUK matet me kohë dhe **NXËNËSI NUK KA FLETË përpara;**
- Administratori lexon tekstin vetëm një herë. Leximi bëhet ngadalë (përafërsisht një fjalë për sekondë);
- Pyetja mund të përsëritet vetëm një herë;
- Nëse nxënësi nuk arrin të japë përgjigje për 10 sekonda, atëherë shënohet “s/ka përgjigje” dhe vazhdohet me pyetjen tjetër!

7. Diktimi

- Ky është një test diktimi. Që testi të rrjedhë si duhet, udhëzimet duhet të ndiqen me **SAKTËSI;**
- Nxënësi do të shkruajë fjalinë e diktuar në hapësirën me vija;
- Fjalja apo fjalët mund të përsëriten më së shumti tri herë;
- Shenjat e pikësimit nuk bën të sugjerohen.

4.7 Shënimi i rregullave për EGRA-n

Pjesë e rëndësishme e testimit është edhe shënimi i saktë i të dhënave. Administratorët duhet të njihen me rregullat për shënimin e testit. Këto rregulla duhet të bëhen automatike dhe, kur të vijë koha për administrimin e testit, të mos ketë nevojë për t’iu referuar ndonjë udhëzimi.

Nëndetyra	Koha	Rregulla e ndërprerjes	Nëse nxënësi nuk ka përgjigje
Vetëdija tingullore	Nuk matet me kohë.	Pa përgjigje të saktë në pesë fjalët e para.	Shëno si të pasaktë. Trego përgjigjen e saktë dhe lexo fjalën tjetër.

Njohja e emrit dhe e tingullit të shkronjës	Aktivizo kohëmatësin pasi nxënësi të thotë shkronjën e parë.	10 shkronjat e para (Rreshti i parë) të pasakta.	Shëno si të pasaktë. Drejtoje te shkronja tjetër dhe thuaj “Vazhdo, të lutem”
Leximi i fjalëve të njohura	Aktivizo kohëmatësin pasi nxënësi të thotë fjalën e parë të njohur.	Asnjë fjalë në rreshtin e parë nuk është lexuar saktë.	Shëno si të pasaktë. Trego fjalën, drejtoje te fjala tjetër dhe thuaj “Vazhdo, të lutem.”
Leximi i fjalëve të panjohura	Aktivizo kohëmatësin pasi nxënësi të thotë fjalën e parë të panjohur.	Asnjë fjalë në rreshtin e parë nuk është lexuar saktë.	Shëno si të pasaktë. Trego fjalën, drejtoje te fjala tjetër dhe thuaj “Vazhdo, të lutem .”
Rrjedhshmëria e leximit me zë	Aktivizo kohëmatësin pasi nxënësi të lexojë fjalën e parë në tekst.	Asnjë fjalë në rreshtin e parë nuk është lexuar saktë.	Shëno si të pasaktë. Trego fjalën, drejtoje te fjala tjetër dhe thuaj “Vazhdo, të lutem,,”
Lexim-kuptimi (Të kuptuarit e leximit)	Kohëmatësi duhet të lëvizë për të monitoruar kohën siç kërkohet.	Bëj VETËM pyetje përkatëse me rreshtin e lexuar nga nxënësi.	Shëno “Pa përgjigje.”Vazhdo pyetjen tjetër.
Të kuptuarit përmes dëgjimit	Nuk matet me kohë.	Asnjë.	Shëno “Pa përgjigje.” Vazhdo me pyetjen tjetër.
Diktimi	Nuk matet me kohë.	Asnjë	Merr fletën. Përfundo testimin.

4.8 Rezultatet e nëntesteve në A-EGRA

Vetëdija tingullore

- Nga 10 fjalë;
- Shënohet numri i fjalëve të lexuara dhe numri i gabimeve, në katror në fletën për shënimin e rezultateve;
- Rezultati do të jetë numri i fjalëve për të cilat nxënësi është përgjigjur saktë (p.sh. numri i përpjekjeve (të lexuarat, pa numrin e gabimeve).

Tingujt e shkronjave

- Nga 100 shkronja;
- Rezultati do të jetë numri i shkronjave të sakta për minutë (shspm);
- Nëse nxënësi nuk e përfundon para se të kalojë koha (p.sh., ka shfrytëzuar plot 60 sekonda). llogaritet numri i shkronjave të lexuara pa numrin e shkronjave që janë shënuar si të pasakta. Ky numër është numri i shkronjave të identifikuara saktë për një minutë, që do të jetë rezultati i të dhënave;
- Nëse nxënësi i ka lexuar të gjitha shkronjat para se të kalojë koha (p.sh., ka përdorur më pak se 60 sekonda), atëherë përdoret formula:

$$\text{shkronjatesaktapërminutë} = \text{shkronjatesakta} * \frac{60}{\text{kohaekaluar}}$$

Fjalët e njohura (fotografike) dhe jofjalët

- Secila është e shënuar nga 50 fjalë;
- Rezultati do të jetë numri i fjalëve të njohura dhe jofjalëve për minutë (fnpm ose fppm);
- Nëse nxënësi nuk e përfundon para se të kalojë koha (p.sh., ka shfrytëzuar plot 60 sekonda), llogaritet numri i fjalëve të lexuara dhe minusohet numri i fjalëve që janë shënuar si të pasakta. Ky numër është numri i fjalëve të identifikuara saktë për një minutë, që do të jetë rezultati i të dhënave;
- Nëse nxënësi i ka lexuar të gjitha fjalët para se të kalojë koha (p.sh. ka përdorur më pak se 60 sekonda), atëherë përdoret formula:

$$\text{fjalëtesaktapërminutë} = \text{fjalëtesakta} * \frac{60}{\text{kohaekaluar}}$$

Rrjedhshmëria e leximit me zë

- Secila është e shënuar nga numri i fjalëve në tregim;
- Rezultati do të jetë numri i fjalëve të lexuara për minutë (fnpm ose fppm);

- Nëse nxënësi nuk e përfundon para se të kalojë koha (p.sh., ka shfrytëzuar plot 60 sekonda), llogarit numrin e fjalëve të lexuara dhe heq numrin e fjalëve që janë shënuar si të pasakta. Ky numër është numri i fjalëve të identifikuar saktë për një minutë, që do të jetë rezultati i të dhënave;
- Nëse nxënësit kanë lexuar të gjitha fjalët para se të kalojë koha (p.sh. ka përdorur më pak se 60 sekonda), atëherë përdoret formula:

$$fjalëtesaktapërminutë = fjalëtesakta * \frac{60}{kohaekaluar}$$

Lexim-kuptimi

- Nga 5 pyetje ose nga numri i pyetjeve që nxënësi është pyetur, bazuar në sasinë e tregimit të lexuar (më herët e shënuar për rrjedhshmëri – më sipër);
- Ky rezultat mund të raportohet në dy mënyra:
 - i) Përqindja e pyetjeve të përgjigjur saktë nga totali i mundshëm (zakonisht 5 pyetje), sasia totale e kuptuar e leximit;
 - ii) Përqindja e pyetjeve të përgjigjura saktë nga numri i fjalëve të lexuara (bazuar në sasinë e tregimit që nxënësit lexuan), sasinë e tregimit të kuptuar të bazuar në atë që është lexuar;
- Gjithashtu mund të raportohet thjesht si numër i pyetjeve të sakta nga totali ose numri i fjalëve të lexuara.

Dëgjim-kuptimi

- Nga 5 pyetje;
- Përqindja e pyetjeve të përgjigjur saktë nga totali i mundshëm (zakonisht 5 pyetje);
- Sasia e kuptuar e tregimit të plotë;
- Gjithashtu mund të raportohet thjesht si numër i pyetjeve të sakta nga totali.

Diktimi

- Pesë fjalë të regjistruara/shënuara, plus pesë pikët e shënuara – hapësira e fjalëve, renditja e fjalëve, shkronja e madhe dhe në fund shenjat e pikësimit;
- Të gjitha fjalët janë të shënuara “saktë” (2 pikë), “pjesërisht e saktë” (1 pikë, përveç shkronjës së madhe dhe germëzimi) dhe “pasaktë” (0 pikë);
- Rezultati raportohet si të gjitha pikët e arritura ose si përqindja e maksimumit të pikëve të mundshme.

5. Reflektim dhe ide për mësimdhënës

Rregullat e përgjithshme

Testi A-EGRA përmban 7 nënteste. Gjatë testimit individual të nxënësve, mësuesi/ja (administruesi/ja i testit) mund të gjykojë vetë nëse dëshiron t'i administrojë të gjitha nëntestet, apo vetëm nëntestet që janë më të rëndësishme për gjendjen e nxënësit.

- Nxënësit duhet të arrijnë një standard të pranueshëm për nëntestet 1 dhe 2 në fillim të klasës së dytë. Vetëm nxënësit me arritje më të ulëta në vetëdijen tingullore dhe fonetike do të duhet të testohen në këto nënteste.
- Nxënësit duhet të arrijnë një standard të pranueshëm për nëntestet 3 dhe 4 deri në fund të gjysmëvjetorit të parë të klasës së dytë. Megjithatë, synohet përmirësimi i vazhdueshëm në këto nënteste. Vetëm nxënësit me arritje më të ulëta në leximin e fjalëve të njohura dhe jofjalëvedo të duhet të testohen në këto nënteste. Gjithashtu mund të mos jetë e dobishme t'iu mbahen këto nënteste nxënësve të cilët kanë vështirësi me nëntestet 1 dhe 2.
- Performanca e nxënësve në nëntestet 5 dhe 6 ka gjasa të ketë rezultate të ndryshme, sepse në këto nënteste edhe në fund të klasës së dytë, një pjesë e konsiderueshme e nxënësve kanë performancë të dobët. Gjithashtu mund të mos jetë e e dobishme t'iu mbahen këto nënteste nxënësve të cilët kanë vështirësi me nëntestet 3 dhe 4. Në të gjitha rastet, në këto nënteste performanca e shumicës së nxënësve ka gjasa të vazhdojë të përmirësohet në klasën e tretë.

Udhëzime për interpretimin e pikëve të nëntesteve

Në vijim do t'i interpretojmë rezultatet e nëntesteve dhe do të japim sugjerime për veprim.

5.1 Nëntesti 1 - Vetëdija tingullore

Arsyetimi

Leximi kërkon kthimin e shkronjave në tinguj, tingujt në fjalë dhe fjalët në kuptim. Nxënësit duhet të kuptojnë se fjalët janë të përbëra nga tingujt të veçantë dhe duhet të dinë se si të ndajnë fjalët në tinguj. Kjo aftësi duhet të zhvillohet patjetër para përfundimit të klasës së parë, sidomos në rastin e gjuhës shqipe e cila është një gjuhë fonetike.

Një nxënës i klasës së dytë që ka vështirësi me këtë nëntest, ka të ngjarë të jetë edhe prapa pjesës tjetër të klasës. Andaj ky nëntest mund të përdoret kryesisht për vlerësimin e nxënësve që kanë vështirësi të konsiderueshme në lexim. Megjithatë, është për t'u brengosur në qoftë se nxënësi bën gabime në germëzim.

Para se të konkludoni se nxënësit kanë vështirësi në të nxënë sa i përket vetëdijes fonemike, fillimisht:

- Sigurohuni se a i keni përcaktuar qartë rezultatet e pritura për vetëdijen fonemike;
- Reflektoni se si i shqiptoni ju fjalët dhe tingujt;
- Sigurohuni se gjatë procesit mësimor nuk përdoret dialekti apo lokalizmat;
- Reflektoni se sa janë bërë ushtrime të shqiptimit të tingujve me nxënësit; Sigurohuni që të punoni në grupe të vogla dhe në mënyrë individuale me nxënës;
- Sigurohuni që keni zgjedhur aktivitete të përshtatshme.

Ide për mësimdhënësit

- Germëzimi i emrit

Ushtrime germëzimi duke filluar nga fjalë të njohura (si p.sh. emri i nxënësit). Nxënësi e germëzon emrin e tij.

- Lojë germëzimi

Nxënësit ndahen në dy grupe ose punojnë në çifte. Mësimdhënësi ose një nxënës tërheq tiketën ku është e shkruar një fjalë (tiketat me fjalë të ndryshme janë përgatitur paraprakisht) dhe e shqipton atë, ndërsa nxënësi tjetër e germëzon. Ai grup ose nxënës që germëzon më së shumti fjalë të sakta, fiton. Kjo lojë mund të zhvillohet edhe pa garuar, si ushtrime në çifte ose në grupe.

- Shiko dhe germëzo

Vizatimet e ndryshme të punuara nga nxënësit apo tiketa me fotografi shfrytëzohen për t'i emërtuar dhe germëzuar. Nxënësit në grupe apo çifte tërheqin tiketën me fotografi apo vizatimin dhe e germëzojnë.

- Fjalët me rimë

Mësimdhënësi përgatit një listë të fjalëve të zakonshme të cilat janë dy nga dy. Gjysma e këtyre fjalëve duhet të rimojnë, ndërsa gjysma tjetër jo. P.sh. mur-gur, miq-fiq (rimojnë) dhe shkollë-bankë, libër-fletore (nuk rimojnë). Mësimdhënësi i lexon nga dy fjalë me radhë, ndërsa nxënësit duhet të gjejnë nëse ato rimojnë apo jo. Pastaj nxënësit i përsërisin fjalët që kanë rimuar. Po ashtu nxënësit mund të gjejnë fjalë të tjera të cilat rimojnë.

- Gjuha sekrete

Përgatit një listë me së paku 30 fjalë. Dhjetë të parat duhet të kenë vetëm dy fonema (p.sh. a-i =ai, t-i=ti etj.), ndërsa 20 të tjerat të kenë nga tri apo katër fonema. Dhjetë nga fjalët me tri apo katër fonema ndahen para zanoreve p.sh. m-al (mal), l-um (lum)

etj. Atëherë mësimdhënësi u thotë nxënësve se do të thotë disa fjalë në një “gjuhë sekrete” dhe fillon të germëzojë fjalët. Nxënësit duhet të gjejnë se cilën fjalë e ka thënë mësimdhënësi, p.sh.: b-a-b-i (babi), g-o-m-a (goma) etj.

- **Ktheje në gjuhë sekrete**

Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit që fjalën të cilën e dëgjojnë ta thonë në gjuhë sekrete të tingujve. P.sh. mësimdhënësi e thotë fjalën shkolla dhe kërkon nga nxënësit që të shqiptojnë tingujt që dëgjojnë sh-k-o-ll-a. Kështu mund të veprojë me fjalë tjera të cilat paraprakisht i ka në listën e përgatitur. Po ashtu nxënësit mund të vazhdojnë aktivitetin në çifte apo grupe.

- **Gjeje tingullin**

Mësimdhënësi shqipton fjalët e caktuara dhe kërkon nga nxënësit të gjejnë se ku është tingulli i caktuar, në fillim, në mes apo në fund të fjalës. P.sh. arti (a-ja në fillim), luani (a-ja në mes), nëna (a-ja në fund).

- **Hiqe tingullin**

Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit që të heqin tingullin e parë nga fjala që dëgjojnë dhe të tregojnë se si do të tingëllojë fjala, p.sh. fjala *derë* do të bëhet *erë*, fjala *mik* do të bëhet *ik* etj. Apo kërkohet që nxënësit të gjejnë se cili tingull është hequr nga fjala e caktuar.

- **Hiqe tingullin e emrit**

Mësimdhënësi kërkon që nxënësit të thonë emrin e tyre pa tingullin e parë të tij dhe pastaj të tregojnë se cilin tingull e kanë hequr (p.sh. Ria në vend të Iria. Tingulli që është hequr është l-ja).

- **Ndërro tingullin**

Mësimdhënësi kërkon që tingullin e parë të emrit ta zëvendësojnë me një tingull tjetër (p.sh. me B atëherë emri Viona do të tingëllonte Biona etj).

- **Shto tingullin**

Mësimdhënësi kërkon nga nxënësit që para fjalëve të caktuara të shtojnë një tingull të caktuar dhe atëherë fitojnë një fjalë të re. P.sh. fjalës *orë*, nëse i shtohet në fillim tingulli *d*, fitohet fjala *dorë* etj.

- **Loja me kukulla**

Nxënësve u thuhet që kukullat kanë dëshirë të luajnë me ta, por ato flasin një gjuhë të çuditshme. Ato i thonë fjalët shumë ngadalë. P.sh. në vend se të thonë fjalën *nxënës*, ato thonë *nxë.....nës*. Atëherë nxënësit duhet t’ia qëllojnë cila fjalë është dhe më pas u tregohet fotografia e asaj fjale. Aktiviteti vazhdohet duke i ndarë fjalët në rrokje, pastaj edhe në fonema.

- Qëllo tavolinën

Nxënësit ulen në tavolinat e tyre. Mësimdhënësi e thotë një fjalë dhe nxënësit duhet të qëllojnë me duar tavolinën aq herë sa tinguj ka fjala që dëgjuan. Nxënësit tregojnë se sa fonema i ka fjala. Atëherë mësimdhënësi i thotë të gjitha fonemat duke i ndarë një nga një. Të njëjtën e bëjnë edhe nxënësit me fjalë të tjera, duke thënë njëri një fjalë, ndërkaq të tjerët e qëllojnë tavolinën për secilën fonemë. Kjo mund të bëhet edhe me rrahje shuplakash, me këmbë në dysheme apo me duar në këmbë.

- Objekti i fshehur

Disa objekte të ndryshme futen në një kuti. Nxënësi e merr një objekt të cilin nuk ua tregon nxënësve të tjerë dhe e ndan në fonema, p.sh. l-u-g-a. Nxënësit e tjerë duhet t'i a qëllojnë se cili objekt është duke i bashkuar fonemat. Pastaj e nxjerrin objektin dhe, edhe njëherë e thonë emrin e tij/e saj.

- Shpejt – ngadalë

Mësimdhënësi e thotë një fjalë p.sh. *futboll* dhe tregon që kjo është mënyra e shpejtë për të thënë atë fjalë dhe pastaj tregon edhe mënyrën e ngadaltë p.sh. f-u-t-b-o-l-l. Secili nxënës mund të përsërisë aktivitetin me fjalë të tjera.

- Rimo me radhë

Mësimdhënësi kërkon që nxënësi të thotë emrin e tij/e saj dhe pastaj kërkon që të gjejë një fjalë që rimon me emrin e tij/e saj. Pastaj e thotë emrin e shokut dhe gjen një fjalë që rimon me të. E thotë emrin e një sendi që e sheh në klasë dhe gjen një fjalë që rimon me të. E thotë emrin e një pjese të trupit dhe pastaj gjen një fjalë që rimon me të. E thotë një ushqim që i pëlqen dhe gjen një fjalë që rimon. Pastaj thotë dy fjalë të çfarëdoshme që rimojnë, pastaj tri fjalë etj.

- Ecim me fjalë, rrokje dhe fjali

Mësimdhënësi e fton një nxënës të cilit i thotë një fjalë dhe ai duhet ta ndajë në fonema, ku për secilën fonemë e hedh një hap. Kështu vazhdon deri në fund të fjalës dhe thotë se sa fonema i ka fjala. Të njëjtën mund ta bëjë duke e ndarë fjalën në rrokje, apo fjalinë në fjalë.

- Lexojuni nxënësve çdo ditë tekste ku ka rimë.
- Mundësojuni nxënësve të dëgjojnë tekste, përralla, libra që lexohen me zë në CD, kasetofon apo kompjuter.

5.2 Nëntesti 2 - Njohja e shkronjave

Arsyetimi

Njohja se si shkronjat korrespondojnë me tingujt është një prej aftësive më të rëndësishme që nxënësit duhet të kenë për t'u bërë lexues të suksesshëm. Nëse

kjo njohuri nuk është fituar, nxënësit mund të përpigjen të mbështeten më shumë në njohjen e fjalëve dhe jo në dekodimin e tyre. Lexuesit e mirë fitojnë njohuri mbi fonetikën nga mesi i klasës së parë. Nëse një nxënës i klasës së dytë ka vështirësi për njohjen e shkronjave (emërtimin e tingullin e shkronjës), kjo kërkon vëmendje të shtuar nga ana e mësimit/ës.

Para se të konkludoni se nxënësit kanë vështirësi në të nxënë sa i përket fonetikës, fillimisht:

- Sigurohuni se a i keni përcaktuar qartë rezultatet e pritura për mësimin e fonetikës;
- Reflektoni nëse janë bërë ushtrime të përshtatshme dhe në mënyrë sistematike me nxënës;
- Reflektoni nëse nxënësit kanë mundësi praktikimi dhe zbatimi të njohurive të fituara;
- Sigurohuni që të punoni në grupe të vogla dhe në mënyrë individuale me nxënës;
- Reflektoni nëse nxënësit lexojnë mekanikisht (alfabetin apo fjalët).

Ide për mësimit/ës

- Gjeje dhe shqiptoje tingullin që mungon

Nxënësve u jepen tiketa me fjalë të cilave u mungon një tingull dhe kërkohet nga ata ta gjejnë dhe ta shqiptojnë tingullin që mungon. P.sh. **_ k o l l a**, te kjo fjalë kërkohet të gjendet tingulli **sh**. Pastaj mund të vazhdohet me fjalë më të gjata dhe me më shumë mungesa të tingujve, p.sh. **_ l _ t u _ a**, nxënësit gjejnë tingujt **f, u, r** dhe i shqiptojnë.

- Qarko shkronjën

Nxënësve u jepen copëza të gazetës dhe kërkohet që ta qarkojnë shkronjën përkatëse. Gjithashtu mund t'u kërkohet që të qarkojnë fjalët që fillojnë me të njëjtin tingull.

- Klasifikimi sipas shkronjës

Ndarja e emrave sipas shkronjës nistore. Në tiketa shkruhen emrat e të gjithë nxënësve veç e veç dhe i jepet nxënësit që t'i klasifikojë sipas shkronjës së parë.

- Lojë me shkronja

Nxënësve u jepen tiketat me shkronja dhe u kërkohet që të krijojnë fjalë të ndryshme, zakonisht me fjalët që i përdorim më shpesh. P.sh: libri, shkolla, nëna, lapsi, shtëpia etj. (mund t'i përdorni tiketat nga pakoja e leximit, apo t'i krijoni vetë, si dhe tabelën me xhepa).

Kjo lojë mund të zhvillohet edhe duke i krijuar emrat e shokëve dhe shoqeve. P.sh. Nxënësit i jepen disa tiketa me shkronja dhe i kërkohet që t'i krijojë emrat e shokëve/


shoqëve të bankës. Mund të mos ia japim të gjitha shkronjat, në mënyrë që vetë nxënësi të dijë dhe ta kërkojë nga mësuesi/ja shkronjën që i mungon.

- Akrostik

Mësimdhënësi formon një fjalë të radhitur vertikalisht me tiketa me shkronja. Nxënësit duhet të gjejnë fjalë që fillojnë me secilën prej shkronjave të radhitura në mënyrë vertikale.

- Krijo shkronja

Nxënësit krijojnë shkronja me materiale të ndryshme, me plastelinë, me penj, me kartuç etj.



- Fjalët më të shpeshta

Zgjedhim fjalë nga fjalët më të shpeshta dhe nxënësit i lexojnë ato me radhë. Pas leximit, fjalën e ndajnë në rrokje dhe shkronja.

- Libri me tregime

Lexojmë një tregim të shkurtër. Nga tregimi i lexuar ndalemi në një fjali. Nga fjalia përcaktohem në një fjalë. Fjalën e përcaktuar nxënësit e lexojnë shkronjë për shkronjë. Pastaj mund ta lexojnë edhe në rrokje. Nëse dëshironi, këtë aktivitet mund ta zgjeroni duke kërkuar nga nxënësit që t'i shkruajnë fjalët e lexuara. (Për lexim mund të shfrytëzohen librat.)

5.3 Nëntesti 3 - Fjalët e njohura (fotografike)

Arsyetimi

Fjalori i "fjalëve fotografike" përbëhet nga fjalët që një individ mund të identifikojë menjëherë pa dekodim. Një fjalori i përshtatshëm i "fjalëve fotografike" ndihmon që nxënësit

të lexojnë rrjedhshëm dhe ta kuptojnë tekstin më lehtë. Është një bazë (bërthamë) e fjalëve më të shpeshta, e quajtur **fjalori i fjalëve fotografike**, të cilat janë të përshtatshme, të kuptueshme, të shkurtra, të përdorshme për nxënësit. Këto “fjalë fotografike” duhet të jenë pjesë e fjalorit të secilit nxënës. Nxënësit duhet të jenë në gjendje t’i njohin dhe t’i lexojnë “fjalët fotografike” sapo t’i shohin, pa pasur nevojë t’i dekodojnë.

Para se të konkludoni se nxënësit kanë vështirësi në të nxënë sa u përket “fjalëve fotografike”, fillimisht:

- Sigurohuni se a i keni përcaktuar qartë rezultatet e pritura për mësimin e “fjalëve fotografike”;
- Sigurohuni se nxënësit i njohin shkronjat;
- Reflektoni se si i lexoni ju fjalët (është me rëndësi që fjala të lexohet si tërësi dhe me intonacion të duhur, jo në rrokje);
- Sigurohuni se nxënësit kanë fond të mjaftueshëm të fjalëve në të folur dhe të shkruar;
- Sigurohuni se nxënësit i kanë mësuar fjalët e parapara për periudhë të caktuar (referoju manualit të leximit për listën e fjalëve) nëpërmjet aktiviteteve të përshtatshme;
- Sigurohuni se nxënësit bëjnë ushtrime të mjaftueshme të të lexuarit (kujdes, mos bëni aktivitete monotone dhe që kërkojnë përsëritje të vazhdueshme);
- Sigurohuni që të punoni në grupe të vogla dhe në mënyrë individuale me nxënës.

Ide për mësimdhënësit

- **Tetëkahorja**

Mësimdhënësi formon vetë tetëkahore, kryesisht me fjalë më të shpeshta të përdorshme, apo edhe mund t’i marrë nga revistat e ndryshme dhe t’i fotokopjojë ato. Nxënësi duhet t’i qarkojë në tetëkahore fjalët e dhëna në një listë të ndarë. Nëse dëshironi, këtë aktivitet mund ta lidhni edhe me nëntestin 2 (fonetikën), ku në vend të listës, mësimdhënësi e thotë fjalën dhe nxënësit duhet ta qarkojnë në tetëkahore.

- **Tiketatat me fjalë më të shpeshta**

Shfaqim para nxënësve (ose grupit të nxënësve) nga një tiketë me fjalë më të shpeshta dhe u themi që ta lexojnë me zë fjalën e shkruar në tiketë. Vazhdohet kështu edhe me tiketatat e tjera. Nëse tiketa nuk lexohet drejt, kthehet në grumbullin e tiketave të palexuara. Kjo mund të matet edhe me kohë. Fillohet me kohë më të shkurtër (p.sh. 30 sekonda) e me më pak fjalë dhe vazhdohet me kohë më të gjatë (p.sh. 45 sekonda, 60 sekonda) e me më shumë fjalë. Ky aktivitet mund të zhvillohet me grupin e madh ku mësuesja i shfaq tiketatat apo në grupe/çifte ku nxënësit i tërheqin vetë tiketatat nga grumbulli i tiketave.

- **Fjalëkryqi**

Mësimdhënësi përgatit një fjalëkryq me fjalë më të shpeshta p.sh. së pari vizaton një objekt (librin, fletoren, lapsin), ndërsa poshtë vendos aq katrorë sa duhet të plotësohet emri i asaj fjale. Nxënësit duhet ta shënojnë fjalën në katrorët e zbrazët dhe ta lexojë atë.

- **Pantomimë**

Ky aktivitet zbatohet në çifte ose në grupe. Mësimdhënësi paraqet tiketa me fjalë të ndryshme (mund të jenë emra kafshësh, si macja, qeni, lopa, kali). Nxënësi tërheq një tiketë dhe tregon me anë të pantomimës se çka fshihet në tiketë. Nxënësit e tjerë duhet t'ia qëllojnë se cila është fjala e shkruar në tiketë.

- **Gjej shkronjat e fjalës**

Mësimdhënësi ose nxënësit mendojnë një fjalë dhe e paraqesin në tabelë, ose letër vetëm me anë të vizave (d.m.th. paraqiten aq viza sa ka shkronja fjala e menduar). Nxënësit e tjerë duhet ta gjejnë fjalën duke thënë shkronja të ndryshme (p.sh. thonë se fjala e menduar a e ka shkronjën L. Nëse është, në vizën adekuate shkruhet shkronja L. Nëse jo, tregohet që nuk e ka këtë shkronjë dhe e shënojmë në një kënd). Mund të caktojmë se sa herë kanë mundësi të provojnë. (p.sh. _____ = L I B R I). Ky aktivitet ndihmon edhe zhvillimin e fonetikës dhe mund të përdoret edhe si aktivitet për fonetikë.



- Shkronjat e përziera

Mësimdhënësi (nxënësi) u jep nxënësve tiketa me shkronjat e një fjale të paraqitura në mënyrë të përzier. Nxënësit duhet t'i radhisin shkronjat saktë për të fituar fjalën e duhur/ fjalë me kuptim. Kjo mund të bëhet edhe duke i shkruar shkronjat në tabelë/letër.

- Qëllo fjalën

Mësimdhënësi apo nxënësi i shënon shkronjat e një fjale në mënyrë të përzier. Nxënësit duhet t'ia qëllojnë se cila fjalë është ajo. Këtë duhet ta bëjnë pa i renditur shkronjat.

- Formo fjalë të reja

Mësimdhënësi apo nxënësi u jep nxënësve tiketa me shkronjat e disa fjalëve (p.sh. 5 fjalë). Nxënësit duhet t'i përziejnë shkronjat dhe të formojnë sa më shumë fjalë të reja duke i përdorur vetëm ato shkronja.

- Fjalët e fshehura

Mësimdhënësi shkruan fjalët më të shpeshta në një fletë. Fjalët i shkruan me shkronja më të mëdha dhe lë hapësirë të mjaftueshme në mes të fjalëve. Mbi të vendos një fletë tjetër e cila e ka të hapur një katror të madhësisë së fjalëve të shkruara. Nxënësit duhet t'i lexojnë fjalët që zbulohen nga lëvizja e fletës së dytë.

Shto prapashtesën

Mësimdhënësi përgatit tiketa ku janë të shkruara ndaras rrënja e fjalës dhe prapashtesat e mundshme. P.sh. në një tiketë shkruhet rrënja top dhe tiketat e tjera shkruhen mbaresat -i, -it, -in, -at, -ave etj. Nxënësit duhet të bashkojnë rrënjën me prapashtesat adekuate dhe t'i lexojnë ato.

- Ndani çdo ditë nga 10 minuta për lexim të fjalëve më të shpeshta.

5.4 Nëntesti 4 - Jofjalët

Arsyetimi

Dekodimi është aftësia për të përdorur saktësisht njohuritë e marrëdhënieve shkronjë-tingull në mënyrë që të shqiptohen dhe të lexohen saktë fjalët të cilat nuk janë pjesë e fjalorit të "fjalëve fotografike". Para se t'i ndërlihdhin fjalët e panjohura me kuptimin e tyre, lexuesit duhet të jenë në gjendje t'i shqiptojnë saktë ato. Të jesh në gjendje të ndërlihdësh kuptimin me fjalën përkatëse të cilën nuk e ke hasur më parë, është një aftësi e domosdoshme për lexuesit. Për t'u siguruar që fjalët e testuara janë me të vërtetë të panjohura, A-EGRA vlerëson aftësinë e nxënësve për të lexuar fjalë të panjohura duke u dhënë atyre një listë me fjalë të pakuptimta, si kombinime shkronjash, që nuk ndjekin asnjë rregull të gjuhës shqipe dhe që në të vërtetë nuk janë fjalë. Nëse nxënësi nuk tregon rezultat të kënaqshëm në nëntestin 4, kjo tregon shkathtësi të dobëta të

dekodimit. Megjithëse nxënësi ka nevojë për shkathtësinë e leximit memorizues, ai gjithashtu ka nevojë për shkathtësinë e dekodimit.

Para se të konkludoni se nxënësit kanë vështirësi në të nxënë sa i përket dekodimit të fjalëve (fjalëve pa kuptim), fillimisht:

- Sigurohuni se keni kuptuar arsyen për mësimin e dekodimit dhe përdorimin e fjalëve pa kuptim;
- Sigurohuni se a i keni përcaktuar qartë rezultatet e pritura për mësimin e dekodimit;
- Sigurohuni që janë zhvilluar aktivitete të përshtatshme me nxënës për dekodimin e fjalëve;
- Sigurohuni që të punoni në grupe të vogla dhe në mënyrë individuale me nxënës;
- Reflektoni nëse keni praktikuar aktivitete të përshtatshme dhe të mjaftueshme për lidhjen e shkronjave mes vete.

Ide për mësimdhënësit

- **Lojë me fjalë**

Secili nxënës merr tiketat me shkronjat e një fjale me kuptim. I përzien ato shkronja dhe e lexon fjalën e krijuar pa kuptim. Aktiviteti mund të vazhdohet duke bërë prapë prapë përzierjen e shkronjave dhe leximin e fjalëve të reja pa kuptim.

- **Formo fjalë pa kuptim**

Në secilin grup të nxënësve vendosen një grumbull tiketash me shkronja. Secili nxënës tërheq një numër tiketash (p.sh. 5) dhe lexon fjalën e formuar (pa kuptim).

- **Formo fjalë me bashkëtingëllore dhe zanore**

Në secilin grup të nxënësve vendosen dy grumbuj tiketash, njëri me bashkëtingëllore dhe tjetri me zanore. Secili nxënës tërheq tiketa nga të dy grumbujt me radhë dhe lexon fjalën e formuar (pa kuptim).

- **Qëlllo çka fshihet**

Përzihen shkronjat e një fjale me kuptim. Nxënësi duhet ta lexojë fjalën pa kuptim dhe pastaj ta gjejë fjalën me kuptim.

- **Lexo së prapthi**

Kërkohet nga nxënësit t'i lexojnë së prapthi emrat e tyre dhe të shokëve, apo edhe fjalë të tjera të njohura.

- **Tetëkahore e çoroditur**

Në tetëkahoren e përgatitur paraprakisht nxënësit duhet të qarkojnë fjalë nga lista e dhënë (fjalë pa kuptim). Fjalët e qarkuara duhet t'i lexojnë.

- **Formo fjalë me rrokje**

Mësimdhënësi përgatit tiketa me rrokje. Këto tiketa i vendos para nxënësve (në grup të madh, në grupe të vogla apo edhe në çifte). Nxënësit duhet t'i bashkojnë në mënyrë të rastësishme nga dy, tri, apo katër rrokje dhe të lexojnë fjalën që e kanë fituar (fjalë pa kuptim).

- **Lexo përmes dritares**

Në një fletë mësimdhënësi shkruan shkronja pa ndonjë rregull të caktuar dhe pa hapësira në mes tyre. Shkronjat duhet të jenë pak më të mëdha dhe të një madhësie. Mbi të vendos një fletë tjetër e cila e ka të hapur një katror të madhësisë së 4 apo 5 shkronjave të shkruara në fletën e parë. Nxënësit duhet t'i lexojnë fjalët (pa kuptim) që zbulohen nga lëvizja e fletës së dytë.

- **Shkruaj dhe lexo së prapthi**

Nxënësit duhet ta shkruajnë së prapthi një fjali të shkurtër. Më pas e lexojnë atë. P.sh. fjalinë "Topi i kaltër kërcen hop-hop" e shkruajnë "Poh-poh necrëk rëtlak i ipot".

- **Fjala e gjatë**

Mësuesi shkruan në tabelë një fjalë të gjatë me kuptim (p.sh. matematika). Nxënësit duhet të formojnë fjalë pa kuptim me shkronjat e fjalës së dhënë. Mësimdhënësi mund të vendosë se me sa shkronja duhen formuar fjalët e reja.

5.5 Nëntesti 5a - Rrjedhshmëria e leximit me zë

Arsyetimi

Lexuesit e rrjedhshëm janë në gjendje të lexojnë shpejt, saktë dhe me intonacion të duhur. Kur lexojnë me zë, lexuesit e rrjedhshëm lexojnë frazat dhe përdorin intonacionin në mënyrë të saktë. Leximi i tyre është i lirshëm, i kuptueshëm dhe ka emocion. Nxënësit që nuk kanë rrjedhshmëri gjatë leximit me zë, gjenden në pozitë të vështirë. Në mënyrë që të kuptojnë atë që lexojnë, nxënësit duhet të jenë në gjendje të lexojnë rrjedhshëm në të dyja rastet, edhe kur lexojnë në heshtje, edhe kur lexojnë me zë. Nëse teksti është lexuar me vështirësi dhe në mënyrë joefikase, atëherë nxënësi do ta ketë vështirë të kujtojë se çfarë ka lexuar, apo të lidhë idetë e shprehura në tekst me njohuritë e tij paraprake. Rrjedhshmëria është e rëndësishme edhe për motivimin, sepse nxënësit që lexojnë me vështirësi kanë më pak dëshirë për të lexuar.

Duke kaluar nga njëra klasë në tjetrën, rrjedhshmëria bëhet gjithnjë e më e rëndësishme, sepse vëllimi i materialeve që kërkohet të lexohen rritet me shpejtësi. Nxënësit, leximi i të cilëve është i ngadalshëm ose me vështirësi, nuk do të mund të arrijnë t'i plotësojnë kërkesat e leximit për nivelin a klasën e tyre.

Para se të konkludoni se nxënësit kanë vështirësi në rrjedhshmëri, fillimisht:

- Sigurohuni se a i keni përcaktuar qartë rezultatet e pritura për rrjedhshmërinë në të lexuar;
- Reflektoni dhe sigurohuni se nuk keni autoritet të tepruar në klasë;
- Sigurohuni se nxënësit kanë liri të shprehjes dhe kanë të drejtë të gabojnë;
- Sigurohuni se nxënësit e respektojnë njëri-tjetrin;
- Sigurohuni se nxënësit nuk kanë frikë nga leximi para të tjerëve;
- Sigurohuni që nxënësit i dinë shkronjat dhe i lidhin ato, kanë fond të mjaftueshëm të fjalëve fotografike, si dhe kanë shkathtësi dekodimi;
- Sigurohuni që në baza ditore t'i kushtoni kohë të caktuar të lexuarit me zë dhe leximit në heshtje;
- Sigurohuni që janë bërë aktiviteteve atraktive që nxisin dëshirën për lexim te nxënësit (për më shumë informata referoju kursit të leximit të BEP-it, me temën Rrjedhshmëria).

Ide për mësimdhënësit

- Tikitat me fjalët më të shpeshta

Mësimdhënësi shpërndan tiketa me fjalët më të shpeshta në secilin grup të nxënësve. Nxënësit i tërheqin tikitat me radhë dhe i lexojnë fjalët që janë të shkruara në to. Në rast se e lexojnë fjalën gabimisht, apo kanë vështirësi në leximin e fjalës, atëherë ajo tikitë prapë kthehet në grumbullin e tikitave. Pas një kohe (kur nxënësit i mësojnë ato fjalë që janë në grumbull), mësimdhënësi mund të shtojë tikitat të tjera me fjalët më të shpeshta.

- Lexo fjalitë

Angazhoje nxënësin që të lexojë fjali të shkurtra dhe të thjeshta. Pasi nxënësi të ketë zotëruar këto fjali, vazhdohet me fjali më të zgjeruara.

- Lojë me role.

Zgjidhet një tekst jo shumë i gjatë, i cili ka disa personazhe. Ndahen rolet në bazë të personazheve që ka teksti. Nxënësit duhet të lexojnë disa herë pjesën e caktuar dhe ta mësojnë përmendësh. Pasi ta kenë mësuar, fillojnë aktrimin e pjesës.

- **Aktro duke lexuar**

Zgjidhet një tekst jo shumë i gjatë me disa personazhe. Ndahen rolet në bazë të personazheve që ka teksti. Nxënësit duhet ta lexojnë pjesën e tyre disa herë para se të fillojë aktrimi. Në këtë rast nuk e mësojnë përmendësh pjesën e tyre, por e lexojnë atë edhe gjatë aktrimit (d.m.th. e mbajnë në duar letrën me tekst). Leximi paraprak bëhet që ata të ndihen më të sigurt dhe kjo ndihmon në rrjedhshmëri.

- **Shokë leximi**

Ndani fëmijët në dyshe në mënyrë të atillë që një lexues i mirë të bashkohet me një lexues më të dobët. Fëmijët ulen përkrah njëri-tjetrit në mënyrë që ta shohin të dy tekstin. Ua përkujtoni nxënësve që të lexojnë me aq zë sa e dëgjon shoku pranë. Nxënësit duhet të lexojnë me radhë, duke filluar nga lexuesi më i mirë dhe pastaj vazhdon lexuesi më i dobët. Ndërrimet mund të bëhen pas çdo fjalie, pas dy fjalish apo pas çdo paragrafi. Synohet që me kohë të ndërrohen rolet që të rritet vetëbesimi i lexuesit më të dobët.

- **Kukulla lexon**

Nxënësit mund ta ushtrojnë rrjedhshmërinë në lexim edhe përmes lojës “Kukulla lexon”. Nxënësit marrin një kukull në dorë. Nxënësit lexojnë duke lëvizur kukullën gjoja sikur ajo po flet.

- **Lexim i pavarur**

Mësimdhënësi zgjedh disa tregime apo libra të vegjël , që janë të përshtatshëm për moshën e nxënësve (fjalët janë të njohura për nxënësit). Nxënësit lexojnë në mënyrë individuale (në heshtje). Është mirë që këtij aktiviteti t’i kushtohet kohë (10 – 15 minuta) së paku tri herë në javë.

- **Imitimi**

Nxënësit lexojnë tregimin, poezinë, paragrafin etj., duke imituar zërin e ndonjë kafshe, luleje, shpendi, insekti, sendi etj.

- **Lexim në rreth**

Nxënësit vendosin se cilin tekst do ta lexojnë në rreth. Atëherë fillojnë leximin me radhë. Nxënësi A lexon fjalinë 1 dhe 2, nxënësi B lexon fjalinë 2 dhe 3, nxënësi C lexon fjalinë 3 dhe 4, e kështu me radhë.

- **Lexo – përsërit – lexo**

Nxënësit ndahen në çifte. Zgjidhet një tregim ose paragraf që është pak më lart se niveli i tyre i leximit. Nxënësi fillon të lexojë, ndërsa shoku e përcjell dhe i qarkon fjalët të cilat i ka lexuar me vështirësi apo i ka lexuar gabim. Pas leximit të parë i rikthehet fjalëve të

cilat i ka lexuar me vështirësi, apo i ka lexuar gabim dhe i lexon edhe një herë. Në fund i rikthehet dhe e lexon më rrjedhshëm edhe një herë tregimin ose paragrafin.

- Leximi me jehonë

Lexoni një pjesë të tregimit duke përdorur shprehjen/emocionin dhe ritmin e duhur (p.sh. mund të lexoni një ose dy fjali). Pazoni dhe lëreni nxënësin ose nxënësit t'i lexojnë pas jush (pra si jehonë) fjalitë që sapo lexuat. Ata duhet të mundohen t'i lexojnë me të njëjtin emocion/shprehje dhe ritëm. (Referoju kursit dhe manualit të leximit).



5.6 Nëntesti 5b - Lexim-kuptimi

Arsyetimi

Lexim-kuptimi ka të bëjë me të kuptuarit dhe interpretimin e asaj që lexohet. Edhe në klasat e para, lexuesit duhet të jenë në gjendje të nxjerrin konkluzione në lidhje me atë që lexojnë: çka është e rëndësishme, cili është fakti, çka e shkaktoi një ngjarje të caktuar, karakteristikat e personazheve etj.

Kështu, të kuptuarit është kombinim i leximit, mendimit dhe arsyetimit. Nxënësit të cilët mund të nxjerrin informacione të paraqitura në mënyrë të drejtpërdrejtë në tekst, por që nuk mund t'iu përgjigjen pyetjeve të nivelit më të lartë, lexojnë në mënyrë jofunksionale dhe nuk duhet të shihen si lexues në fazat e leximit të hershëm dhe me progres normal, andaj kanë nevojë për udhëzime për përdorimin e shkathtësive të ndryshme të leximit.

Prandaj, testi A-EGRA vlerëson të kuptuarit në nivele të ndryshme: nxjerrjen e informacionit të dhënë në mënyre të drejtpërdrejtë brenda një fjalie; nxjerrjen e informacionit të dhënë brenda dy fjalive, nxjerrjen e informacionit nga njohuri të përgjithshme dhe jo nga informata të dhëna në mënyrë të drejtpërdrejtë, si dhe përdorimi i njohurive të përgjithshme për të bërë një gjykim të asaj që është lexuar.

Para se të konkludoni se nxënësit kanë vështirësi në lexim-kuptim, fillimisht:

- Sigurohuni se i keni përcaktuar qartë rezultatet e pritura për lexim-kuptim;
- Sigurohuni se nxënësi ka fjalor të mjaftueshëm;
- Sigurohuni se pyetjet që ua bëni nxënësve u përgjigjen niveleve të ndryshme të Taksonomisë së Blumit, duke filluar nga niveli më i ulët deri te ai më i lartë;
- Sigurohuni se bëni pyetje të drejtpërdrejta, të nënkuptuara dhe të menduarit kritik gjatë tri fazave para, gjatë dhe pas leximit (referoju kursit të leximit të BEP-it);
- Sigurohuni që nxënësit i kanë përvetësuar strategjitë e të kuptuarit të cilat ju i keni modeluar dhe praktikuar (referoju kursit të leximit të BEP-it);
- Sigurohuni se nxënësit kanë liri të shprehjes, të drejtë të parashtrorjnë pyetje dhe kanë të drejtë të gabojnë;
- Sigurohuni se ju dhe nxënësit e respektoni njëri-tjetrin (kur njëri flet, të tjerët dëgjojnë);
- Sigurohuni që të punoni në grupe të vogla dhe në mënyrë individuale me nxënës.

Ide për mësimdhënës

- Lexim me ndalesa

Mësimdhënësi ndan tekstin në paragrafë (tërësi logjike). Nxënësit lexojnë në heshtje paragrafin e parë dhe e diskutojnë apo u përgjigjen pyetjeve të mësimdhënësit (me gojë apo të shkruara). Vazhdon njëllor edhe me paragrafët e tjerë. Parashtrimi i pyetjeve të mira është shumë i rëndësishëm. (Për këtë referoju manualit dhe kursit të leximit).

Pasi të përfundojë në tërësi leximi i tekstit, diskutohet në lidhje me përmbajtjen, porosinë, mendimin personal të nxënësve etj.

- Pyetje për ty

Në grupe të vogla ose në çifte, nxënësit i parashtrorjnë pyetje njëri-tjetrit ose grupi-grupit, në lidhje me tekstin e lexuar. Këto pyetje mund të parashtrihen me gojë apo t'iu jepen në formë të shkruar.

- Lexim në dyshe

Nxënësit lexojnë një tekst në çifte. Me të përfunduar leximin, njëri nxënës komenton pjesën e lexuar, ndërsa tjetri parashtron pyetje. Pastaj i ndërrojnë rolet.

- **Diagrami i Venit**

Nxënësit lexojnë tekstin e ndarë në paragrafë. Pastaj në Diagramin e Venit paraqesin karakteristikat e përbashkëta dhe të veçanta lidhur me personazhet e tekstit të lexuar.

- **Dora e pyetjeve**

Nxënësit lexojnë tekstin e dhënë. Pas leximit parashetrojnë pyetje lidhur me tekstin në secilin gisht të dorës (të cilën e kanë vizatuar paraprakisht). Nxënësit i ndërrojnë fletët me pyetje dhe përgjigjen në pyetjet e shokut. Mund të vazhdohet me diskutim të përgjithshëm. Me qëllim të lexim-kuptimit, mund të përdoren edhe organizues të tjerë grafikë (si p.sh. korniza e tregimit, piramida, ylli etj.).

- **Gjeje fjalën e duhur**

Nxënësve iu jepet një tekst nga i cili janë hequr disa fjalë. Nxënësit duhet të gjejnë se cila fjalë duhet të vendoset në zbrazëtirën përkatëse në mënyrë që teksti të ketë kuptim.

Këto fjalë mund t'u jepen si listë e veçantë apo mund t'u lihet nxënësve që t'i zgjedhin vetë.

- **Gjej titullin**

Nxënësit lexojnë tekstin e dhënë pa titull. Pas leximit në grup të vogël diskutojnë dhe vendosin për titullin më të përshtatshëm. Kjo mund të bëhet edhe duke e ndarë tekstin në paragrafë, ku nxënësit duhet të gjejnë nga një titull për secilin paragraf.

- **Mesazhet e përenditura**

Secilit grup i jepet një tekst, i ndarë në fjali që janë të shkruara në shirita letre. Këto fjali u jepen të përziera. Nxënësit duhet t'i radhisin për të krijuar një tekst me kuptim. Këto fjali mund t'i vendosin në tabelën me xhepa.

- **Strategjitë e të kuptuarit**

Për të kuptuar tekstin e lexuar, nxënësit duhet t'i praktikojnë strategjitë e të kuptuarit të cilat i modelon mësimdhënësi dhe bëhen pronë e nxënësve. Këto strategji janë: parashikimi, vizualizimi, bërja e pyetjeve, bërja e lidhjeve, leximi mes rreshtave, caktimi i rëndësisë dhe përmbledhja. Për më shumë informata rreth këtyre strategjive, referoju manualit dhe kursit të leximit.

- **Vizualizimi**

Pas leximit të tekstit, mësimdhënësi kërkon nga nxënësit që ta përshkruajnë imazhin të cilin e kanë krijuar lidhur me atë që kanë lexuar. Pasi përshkruajnë imazhin, nxënësit mund ta vizatojnë atë.

5.7 Nëntesti 6 - Dëgjim-kuptimi

Arsyetimi

Dëgjim-kuptimi zakonisht nuk mësohet në shkollë, por fitohet natyrshëm. Prandaj testimi i dëgjim-kuptimit veçmas nga lexim-kuptimi është shumë i rëndësishëm, sepse të testuarit e dëgjim-kuptimit është një tregues i zhvillimit gjuhësor të nxënësit. Performanca e dobët në dëgjim-kuptim është tregues se nxënësit nuk kanë fond të mjaftueshëm të fjalëve në fjalorin e tyre, gjë që pritet edhe nga materialet e leximit. Performanca e mirë në dëgjim-kuptim, e kombinuar me performancë të dobët në lexim-kuptim, është tregues i vështirësive në lexim.

Para se të konkludoni se nxënësit kanë vështirësi në dëgjim-kuptim, fillimisht:

- Sigurohuni se i keni përcaktuar qartë rezultatet e pritura për dëgjim-kuptim;
- Sigurohuni se materialet që u lexohen nxënësve janë interesante dhe të përshtatshme për moshën e tyre;
- Sigurohuni se nxënësit janë të motivuar (referoju manualit të leximit);
- Reflektoni për menaxhimin e klasës;
- Sigurohuni se keni bërë një listë të pyetjeve për pjesën që do të lexoni;
- Sigurohuni se bëni pyetje të drejtpërdrejta, të nënkuptuara dhe të menduarit kritik gjatë tri fazave para, gjatë dhe pas leximit (referoju kursit të leximit BEP);
- Sigurohuni se nxënësit kanë kohë të mjaftueshme për t'u përgjigjur;
- Sigurohuni se nxënësit kanë liri të shprehjes dhe të të bërit pyetje;
- Sigurohuni se mbani balancë gjatë diskutimit në klasë (mësimdhënës – nxënës, nxënës – nxënës)
- Sigurohuni se nxënësit kanë fond të mjaftueshëm të fjalëve në fjalorin e tyre.



Ide për mësimdhënës

- **Vazhdo tregimin**

Mësimdhënësi ose një nxënës e lexon një pjesë të tregimit me zë, ndërsa nxënësit tjerë e vazhdojnë tregimin sipas dëshirës. Këtë mund ta bëjnë me gojë apo në formë të shkruar.

- **Lexim me ndalesa**

Mësimdhënësi ndan tekstin në paragrafë (tërësi logjike). Mësimdhënësi lexon me zë paragrafin e parë dhe nxënësit e diskutojnë përmbajtjen ose u përgjigjen pyetjeve të mësimdhënësit (me gojë apo me shkrim). Vazhdon njëllonj edhe me paragrafët e tjerë. Parashtrimi i pyetjeve të mira është shumë i rëndësishëm. (Për këtë referoju manualit dhe kursit të leximit).

Pasi të përfundojë në tërësi leximi i tekstit, diskutohet në lidhje me përmbajtjen, porosinë, mendimin personal të nxënësve etj.

- **Pyetje për ty**

Nxënësit i parashtrojnë pyetje njëri-tjetrit ose grupi-grupit në grupe të vogla ose në çifte, , në lidhje me tekstin e lexuar me zë nga ana e mësimdhënësit apo nga një nxënës. Këto pyetje mund të parashtrihen me gojë apo t'iu jepen në formë të shkruar.

- **Unë lexoj, ti dëgjo**

Në çifte njëri nxënës lexon një tekst me zë. Me të përfunduar leximin, nxënësi tjetër komenton pjesën e dëgjuar, ndërsa lexuesi parashtron pyetje. Pastaj i ndërrojnë rolet.

- **Diagrami i Venit**

Mësimdhënësi lexon me zë tekstin e ndarë në paragrafë. Pastaj në Diagramin e Venit nxënësit paraqesin karakteristikat e përbashkëta dhe të veçanta lidhur me personazhet e tekstit të lexuar.

- **Dora e pyetjeve**

Mësimdhënësi lexon një tekst. Pas leximit, u shpërndan nxënësve fletën me dorën e pyetjeve. Nxënësit përgjigjen në pyetjet e parashtruara. Pas plotësimit të fletëve, mund të vazhdohet me diskutim të përgjithshëm. Me qëllim të dëgjim-kuptimit, mund të përdoren edhe organizues të tjerë grafikë (si p.sh. korniza e tregimit, piramida, ylli etj.).

- **Gjej titullin**

Mësimdhënësi lexon një tekst pa ua treguar titullin nxënësve. Pas leximit, secili grup duhet të mendojë për titullin më të përshtatshëm dhe të argumentojë atë. Në fund në grup të madh diskutojnë idetë e tyre.

- **Strategjitë e të kuptuarit**

Për të kuptuar tekstin e lexuar, nxënësit duhet t'i praktikojnë strategjitë e të kuptuarit të cilat i modelon mësuesi dhe bëhen pronë e nxënësve. Këto strategji janë: parashikimi, vizualizimi, bërja e pyetjeve, bërja e lidhjeve, leximi mes rreshtave, caktimi i rëndësisë dhe përmbledhja. Për më shumë informata rreth këtyre strategjive referoju manualit dhe kursit të leximit.

- **Vizualizimi**

Pas leximit të tekstit, mësuesi kërkon nga nxënësit që ta përshkruajnë imazhin të cilin e kanë krijuar lidhur me atë që kanë dëgjuar. Pasi përshkruajnë imazhin, nxënësit mund ta vizatojnë atë.

- **Radhitja e fjalive**

Mësuesi lexon një tekst dhe u shpërndan grupeve 3 – 4 fjali nga teksti, të cilat nxënësit duhet t'i radhisin sipas radhës që paraqiten në tekst.

- **Audio tregime**

Nxënësve mund t'iu lëshohen tregime të incizuara në CD. Pas dëgjimit të tregimit u parashirohen pyetje dhe vazhdohet me diskutim.

5.8 Nëntesti 7 - Diktimi

Arsyetimi

Nëntesti i diktimit mund të shihet edhe si testim i procesit të leximit në veçanti, por nga ana e kundërt. Aftësia e nxënësve të dëgjojnë tingujt dhe me saktësi t'i shkruajnë ata në shkronja dhe fjalë që korrespondojnë në tingujt që dëgjojnë, tregon suksesin e tyre me parimet alfabetike. Aftësia e tyre për të shkruar një fjali me saktësi tregon zotësinë e tyre në gramatikë. Dhe aftësinë e tyre për të prodhuar konventat kryesore të shkrimit, tregon aftësinë e tyre për të përdorur këto konventa, si pjesë e procesit të leximit.



6. Krijohet vetë EGRA-n tënde

Format momentale të A-EGRA-s janë përpiluar duke shfrytëzuar një sërë burimesh të ndryshme të materialeve:

- a) Njohja e shkronjave:** Shkronjat e alfabetit janë ndarë në tri grupe shkronjash, sipas radhës që mësohen. Kjo është bërë që të mundësohet organizimi i shkronjave në nëntestin e “njohjes së shkronjave” në bazë të vështirësisë; por edhe t’iu mundësohet mësimdhënësve të përpilojnë teste për njohjen e shkronjave të cilët i përdorin vetëm shkronjat më “të lehta” apo “të vështira”, apo të cilat janë më relevante në gjysmëvjetorin e parë apo të dytë të klasës së parë.
- b) Fjalori fotografik:** “Fjalori fotografik” është përpiluar për klasën e dytë dhe përmban 200 fjalë të rëndësishme dhe të shpeshta dhe 100 emra. Për çështje praktike është ndarë në katër grupe – sipas klasave (klasa I dhe II) dhe sipas gjysmëvjetorëve (i parë dhe i dytë). Kështu që mësimdhënësi mund ta përdorë këtë listë për ta udhëzuar mësimdhënien e fjalëve fotografike dhe për të përpiluar teste për fjalët fotografike të përshtatshme për klasën e parë apo të dytë, si dhe për gjysmëvjetorin e parë apo të dytë të klasave përkatëse.
- c) Vetëdija tingullore:** Një nën-listë e ndarë prej rreth 60 fjalësh është zgjedhur nga lista kryesore e fjalorit fotografik për t’u përdorur për përgatitjen e testeve të “vetëdijes tingullore”. Edhe këtu fjalët nga lista janë ndarë në “të lehta”, “mesatare” dhe “të vështira”.
- d) Dëshifrimi i jofjalëve:** Fjalët e gjuhës shqipe janë analizuar për t’i identifikuar kombinimet e ndryshme të shkronjave të cilat përdoren më shpesh. Gjetjet nga kjo analizë janë shfrytëzuar për t’u përpiluar një listë e jofjalëve, të cilat mund të përdoren për t’i vlerësuar shkathtësitë e dëshifrimit, pavarësisht njohjes së fjalëve. Lista është e ndarë në tri grupe - “të lehta”, “mesatare” dhe “të vështira”. Testi i dëshifrimit të jofjalëve në A-EGRA i përfshin të tria grupet; por është e mundur të zgjidhen jofjalët vetëm nga njëri nivel, për të përpiluar teste dëshifrimi në nivele të ndryshme të vështirësisë.
- e) Tekstet për lexim-kuptim dhe pyetjet:** Janë përpiluar disa tekste, shembuj për klasën e dytë. Ato janë menduar si shembuj praktikë nga të cilët mësimdhënësit mund të mësojnë dhe t’i përdorin. Secili tekst është i përcjellë me llojlojshmëri pyetjesh, të llojeve dhe niveleve të ndryshme. Këto tekste mund të përdoren për mësimdhënie por edhe për vlerësim. Kur ndonjëri nga këto tekste përdoret për vlerësim, nevojiten vetëm rreth pesë pyetje, prandaj mësimdhënësi mund të zgjedhë nga pyetjet e dhëna, në bazë të shkathtësisë që vlerësohet apo vështirësisë, apo të dyja. Për shembull, mësimdhënësi mund të zgjedhë pyetjet për të vlerësuar vetëm nxjerrjen e njohurive të drejtpërdrejta, por në nivele të ndryshme të vështirësisë; apo mund të vlerësojë një set të balancuar të shkathtësive duke përdorur vetëm pyetjet “e lehta”.

Të gjitha këto materiale gjenden në ueb-faqen e BEP-it: <http://sq.bep-ks.org/egrash/>. Mësimdhënësit dhe hulumtuesit mund t'i shfrytëzojnë këto burime për ta përpiluar versionet e tyre të nëntesteve të A-EGRA-s. Mirëpo mund të përdoren edhe për t'i vlerësuar nivelet e ndryshme, si për shembull, një test i fjalorit fotografik për klasën e parë, apo për të vlerësuar shkathtësitë e ndryshme, si për shembull, një test për lexim-kuptimin i cili fokusohet në nxjerrjen e informatave të drejtpërdrejta, apo nxjerrjen e informatave të nënkuptuara, ose të menduarit kritik.

Për vlerësimin në klasë, mësimdhënësit mund të zgjedhin nga këto burime në çfarëdo mënyre që dëshirojnë. Ndërsa, për ata që dëshirojnë të përpilojnë teste për "hulumtim cilësor" (për shembull, për përdorim gjatë hulumtimit në veprim), procedurat janë përkthyer në ueb-faqe për zgjedhje të rastësishme nga këto burime.

7. Çfarë thanë mësimdhënësit

Disa mësimdhënës në Kosovë kanë pasur rastin të jenë pjesë e kursit A-EGRA dhe ta zbatojnë testin A-EGRA me nxënësit e tyre. Në vijim mund të lexoni çfarë thanë disa nga mësimdhënësit për përvojën e tyre me A-EGRA-n.

Gjatë përvojës sime si mësuese kam hasur në sfida të ndryshme, sfida këto që nuk do të mund t'i tejkaloja vetëm. Mendohesha të gjeja një rrugëzgjidhje se si t'i tejkaloja këto probleme. Gjithmonë e kam vlerësuar leximin e rrjedhshëm dhe pa gabime, por nuk gjeja metoda që ta përmirësoja atë. Provoja shumë teknika, por kursi EGRA më ka ndihmuar shumë. Janë teknika që me të vërtetë të ndihmojnë të ecësh përpara, të përvetësosh atë që te nxënësit e kemi problemin më të madh, pra leximin.

Disa nga teknikat që i kam përdorur e që më kanë ndihmuar shumë janë: Aktro duke lexuar, Lexim i pavarur, Pantomima etj.

E kam aplikuar sërish testin vlerësues dhe kam vërejtur ndryshime të dukshme që mua më kanë bërë të ndihem me të vërtetë mësuese e suksesshme.

Valbona Rama - Vushtrri

Kam pasur fatin të jem pjesë e këtij kursi, i cili më ka ndihmuar shumë, sepse me administrimin e tij kam arritur të kuptoj vështirësitë që i kanë nxënësit e mi në komponentët e lexim-shkrimit. Duke përdorur testin EGRA, ne arrijmë të kuptojmë se ku nevojitet më shumë punë dhe përkrahje për fëmijët në klasat e hershme. Ky test shërben si një shembull i përdorimit të vlerësimit për nxënie.

Testi EGRA përbëhet prej disa nëntestëve që na mundëson të ndalemi aty ku fëmijët hasin në vështirësi. Te nëntestet e para nuk ka pasur ngecje, por te nëntesti i rrjedhshmërisë me zë, lexim–kuptimi dhe dëgjim–kuptimi, ka pasur vështirësi.

Idetë e ofruara nga ky kurs më kanë mundësuar që nxënësit t'i tejkalojnë vështirësitë në shkathtësinë e leximit dhe të shkrimit. Pastaj më kanë ofruar njohjen e shumë teknikave për të përvetësuar si duhet leximin dhe kuptimin e tij. Për ta tejkaluar këtë ngecje, unë kam bërë punë shtesë në mënyrë që t'i arrij rezultatet e duhura me nxënës. Tani, të 41 nxënësit e klasës sime janë në gjendje të lexojnë dhe të kuptojnë atë që e lexojnë, por edhe në ushtrim shkrimi janë shumë të mirë në saje të testit EGRA.



Shemsije Shyti, Mitrovicë

Qëllimi i A-EGRA-s është të informojë mësimdhënësin për nivelin e arritshmërisë dhe nevojën për përmirësim.

A-EGRA ka një rëndësi të jashtëzakonshme. Ekzistenca e një testi të tillë ka një vlerë të madhe për të gjithë mësimdhënësit. Testi A-EGRA na mundëson të bëjmë identifikimin e problemit që në fillim. Kjo do të thotë shumë për ne si mësuese, sepse sa më herët e identifikojmë problemin, aq më herët do t'i qasemi atij dhe mundësia për përmirësim të problemit do të jetë më e madhe.

Përveç identifikimit të problemit, A-EGRA na ndihmon edhe me udhëzime se çfarë duhet të bëjmë më tutje. Ofron udhëzime për mësimdhënësit, si dhe një numër të madh teknikash dhe aktivitete për t'u ndihmuar nxënësve. Përdorimi i larmishëm i teknikave që ndikojnë direkt në të mësuarit, aty ku e shohim problemin, qe është çelësi i problemit.

Nxënësit, përpos që do mësojnë nga këto teknika e aktivitete, ata edhe do të argëtohen. A-EGRA ndihmon që nxënësit të jenë më të shkathët në kthimin e shkronjave në tinguj, tingujt në fjalë dhe fjalët në kuptim, t'i ndajnë fjalët në tinguj, të jenë më të hapur, pastaj ofron mundësi që nxënësit të bëjnë pyetje dhe të kërkojnë përgjigje, t'i zbatojnë ato që kanë mësuar në zgjidhjen e problemeve, të dëgjojnë njëri-tjetrin dhe të debatojnë për idetë e tyre.

Sfida kryesore në leximin e shpejtë dhe kuptimin e asaj që lexohet nuk është vetëm insistimi që nxënësit të lexojnë, por të diskutohet ajo që lexohet në mënyrë që nxënësit të mendojnë në mënyrë kritike, apo, thënë ndryshe, të kenë mendimin e vet në lidhje me atë temë. E gjithë kjo kontribuon në arritjen e qëllimeve dhe objektivave themelore të arsimit.



Zyla Osmani, Prishtinë

Jeta na sjell përvoja të ndryshme gjatë punës që ne bëjmë.

Nga përvoja ime 22-vjeçare mund të them se A-EGRA më ndihmoi që më me lehtësi të identifikoj nivelin e nxënësve në lexim.

Ky test individual më mundëson që për 15 minuta të shoh se ku ka vështirësi nxënësi dhe më ndihmon të vendos ku (në cilën fushë) mund të intervenoj.

Intervenimin e bëj me aktivitete të ndryshme në klasë, si dhe bashkëpunoj edhe më prindërit. Me përsëritjen e aktiviteteve në fusha të ndryshme, aty ku ka nevojë, ata arrijnë t'i eliminojnë këto vështirësi

Bahtie Ahmeti

EGRA është një test që diagnostifikon dhe gjen saktësisht vështirësitë që nxënësit hasin në lexim dhe kuptim të teksteve. Unë personalisht e kam përdorur këtë test me nxënësit e mi që në klasën e dytë dhe më ka ndihmuar t'i identifikoj problemet që disa nxënës kanë pasur në lexim. Pastaj duke përdorur teknikat nga udhëzimet e EGRA-s kam arritur që në masë të madhe t'i evitoj vështirësitë që kanë hasur nxënësit e mi si në lexim, po ashtu edhe në kuptimin e teksteve të lexuara.

Mendoj se testi EGRA i duhet çdo mësuesi/eje, sepse kur vështirësitë apo problemet që hasin fëmijët në lexim-kuptim vërehen dhe evitohen që në fillim, sukcesi për t'i bërë fëmijët lexues të mirë dhe të suksesshëm është i garantuar.

Mirjeta Hetemi, Prishtinë

Unë kam pasur fatin të marr pjesë në EGRA dhe të zhvillohem profesionalisht gjatë rrugëtimit. Personalisht mendoj se EGRA nuk është vetëm një testim i nxënësve, por edhe vetëdijësim i mësimitdhënësve për atë që pritet prej tyre. Për mua, ky rrugëtim ka qenë një kthim i kamerës kah vetja, një analizë e punës së bërë, një vërshim idesh për ta përmirësuar gjendjen aktuale në lidhje me leximin. Kam kuptuar se nxënësi është një laps që lakohet, e nga ne varet se si do ta formojmë. Mjafton vullneti e përdorimi i ideve për të punuar. Nga nxënësi merr po atë që ofron. EGRA të ndihmon të krijosh mendimtarë kritikë.



Adelina Metaj, Istog

Për EGRA-n për herë të parë kam dëgjuar në kursin e leximit të organizuar nga BEP-USAID-i, kur isha duke punuar me klasën time të pestë. Aty jam njohur me nëntestet e EGRA-s dhe të them të drejtën më vinte keq që nuk mund t'i përdorja në klasën time, pasi ato kishin të bënin me nxënës nga klasa e parë deri në fund të klasës së dytë.

Më në fund e mora klasën e parë dhe që në fillim identifikova disa nxënës që nuk ishin në hap me të tjerët gjatë njohjes globale të shkronjave. Nga frika që vështirësitë do të barteshin kur të fillojë mësimi i leximit, që me shkronjat e para me të njëjtit nxënës, me shumë dëshirë pranova kursin e hulumtimit në veprim dhe kuptohet që vendosa të përdorja testin e modifikuar të EGRA-s me nxënësit që kishin vështirësi në njohjen e shkronjave.

EGRA më ka ndihmuar të identifikoj dhe vërtetoj saktë ku janë vështirësitë në të cilat hasin nxënësit e klasës sime dhe në çka duhet ta fokusoj punën time

për t'u ndihmuar, sepse asnjëri nga ata nuk kishin vështirësi të njëjta. Njëri kishte vështirësi në vetëdijen tingullore, tjetri në njohjen e emrit të shkronjës e i treti të dy vështirësitë. Pastaj kam planifikuar punën time për tejkalimin e këtyre vështirësive të nxënësve të mi. Rezultatet e testimit të dytë me EGRA-n për hulumtimin në veprim kanë dalë pozitive. Sot vetëm njëri nga nxënësit e mi ka ende vështirësi në lexim dhe atë për arsye të problemeve shëndetësore. Pra EGRA më ka ndihmuar që të identifikoj edhe nxënësit që kanë vështirësi psikofizike në lexim dhe jo vetëm vështirësitë e zakonshme.



Luljeta Rama, Mitrovicë

Me përdorimin e nëntesteve të A-EGRA-s, matja e nivelit të leximit të nxënësve në klasën e dytë është shumë e lehtë, meqë këto nënteste u tregojnë saktësisht mësimdhënëses se në ç'nivel ka arritur nxënësi, apo ku duhet të punojë më shumë që të ngrihet niveli i leximit të nxënësit. Gjithashtu këto nënteste ndihmojnë edhe në ngritjen e vetëbesimit të nxënësit, sepse nxënësit testohen individualisht dhe larg syve të moshatarëve të tyre, gjë e cila i bën fëmijët të ndjehen mirë dhe të sigurt, duke mos e vrarë mendjen se bashkëmoshatarët do ta tallin, apo do ta përqeshin për mosnjohjen e shkronjave të caktuara apo për moslexim të rrjedhshëm. Përparësi tjetër e nëntesteve të EGRA-s është që fakti që i jep mundësi mësimdhënëses t'i qaset në mënyrë të saktë problemit që kanë nxënësit në fushën e leximit, meqë këto nënteste e identifikojnë saktësisht arritjen e nxënësit në lexim. Por vetëm të identifikosh arritjen e nxënësve në lexim, nuk i ndihmon nxënësit që të lexojë më rrjedhshëm. Tashmë kemi larmi teknikash të cilat i ndihmojnë mësimdhënëses që t'u qaset nxënësve lehtësisht për t'i bërë lexues të mirë dhe që e duan leximin, madje të gjithë nxënësve

njëherësh apo edhe individualisht, varësisht si ta shohë të arsyeshme mësuesja dhe sipas nevojës që kanë nxënësit. Kur them individualisht nuk nënkuptoj që mësime të punojë jashtë orarit mësimor me nxënës të caktuar, por gjatë procesit mësimor ajo shumë lehtë mund t'i zbatojë këto teknika, ndërsa nxënësit e tjerë mund t'i angazhojë me detyra të tjera. Të punosh me nëntestet e EGRA-s është kënaqësi jo vetëm për nxënësit, por edhe mësime të tjerë. Shpeshherë mësime të tjerë tona janë ndodhur para pikëpyetjeve të mëdha: Si t'ia bëj me X nxënësin i cili po lexon, por nuk po e kupton atë që e lexon? Si të veproj me nxënësin i cili po i kalon rreshtat në tekst? Çfarë të bëj me nxënësin i cili nuk i germëzon shkronjat në një fjali të shkurtë?, e pikëpyetje të tjera që i kanë preokupuar mësime të tjerë. Nëntestet e EGRA-s u japin zgjidhje këtyre dilemave të mësimeve, meqë me to mund të identifikojmë ngecjet e nxënësve në lexim dhe gjithashtu duke përdorur teknika të ndryshme mund t'i nxjerrim nxënësit nga rreziku. EGRA është formula më e përshtatshme që vërtet jep rezultate dhe kënaqësi të nxënësit.



Besa Zeqiri, Ferizaj.

8. Si ta bëni një hulumtim në veprim duke përdorur A-EGRA-n

Sekreti i suksesit si mësimdhënës është rritja dhe mësimi i vazhdueshëm. Secila situatë e mësimdhënies është e veçantë në shumë aspekte, duke përfshirë shkathtësitë e nxënësve dhe stilet e të nxënësve, si edhe shkathtësitë e mësimdhënësit dhe stilet e mësimdhënies. Mësimdhënësi duhet të gjejë atë që funksionon më së miri në një situatë të caktuar. Hulumtimi në veprim është një mënyrë për ta bërë këtë; dhe sfida gjatë hulumtimit mund ta rifreskojë ndjenjën e kënaqësisë në lidhje me mësimdhënien.

Nëse së fundmi keni provuar një strategji të re në klasë, e keni planifikuar ndonjë orë mësimore më ndryshe, apo po kërkonin ndonjë qasje alternative për t'u marrë me ndonjë problem në klasën tuaj, atëherë tashmë jeni rrugës për ta bërë hulumtimin në veprim. Duke e bërë procesin më sistematik, duke e planifikuar me kujdes, duke vepruar në mënyrë sistematike, duke vlerësuar e duke i përdorur mjetet e dëshmuara, ju mund ta bëni ndryshime të thjeshta në mësimdhënien tuaj deri në nivel të hulumtimit në veprim efektiv dhe të vlefshëm.

Çdoherë kur një mësimdhënës përdor informata nga rezultatet e vlerësimit, apo testimit për ta udhëzuar zgjedhjen e strategjive të mësimdhënies, atëherë mësimdhënësi është duke bërë një formë të hulumtimit në veprim. EGRA u ofron mundësi mësimdhënësve për ta përdorur vlerësimin në një mënyrë më të fokusuar dhe më informative. Mësimdhënësit mund të zgjedhin nënteste të EGRA-s, apo të përpilojnë teste nga banka e burimeve, të cilat vlerësojnë një shkathtësi të caktuar në një nivel të caktuar. Kjo i mundëson mësimdhënësit të gjykojnë me saktësi ndikimin e një teknike apo materialeve të caktuara.

Për shembull, një mësimdhënës mund ta identifikojë një pyetje hulumtuese në lidhje me ndikimin e një teknike të caktuar në të nxënësve në klasë. Ata mund ta përcaktojnë pyetjen hulumtuese si: "Cili është ndikimi i (p.sh.) leximit të përbashkët në të nxënësve?" Përdorimi i EGRA-s për vlerësimin e ndikimit i mundëson mësimdhënësit ta përcaktojnë llojin e të nxënësve të cilin po kërkon. Për shembull, mësimdhënësi mund të dëshirojë ta dijë ndikimin e leximit të përbashkët për njohjen e shkronjave dhe fjalorin fotografik, apo në rrjedhshmëri dhe të kuptuar. EGRA ka nënteste të ndara për të gjitha këto shkathtësi, kështu që mësimdhënësi është në gjendje ta vlerësojë përparimin në shkathtësi të caktuara, në vend se ta bëjë këtë vetëm në përgjithësi, duke administruar teste të caktuara para dhe pas mësimdhënies.

Në vijim mësimdhënësi mund të dëshirojë ta krahasojë ndikimin e leximit të përbashkët në njohjen e shkronjave dhe fjalëve me program të zakonshëm të mësimdhënies, apo me ndonjë teknikë tjetër si përsëritja për njohjen e shkronjave dhe fjalëve. Për ta bërë këtë, mësimdhënësi duhet të bashkëpunojë me një apo më shumë kolegë. Secili prej tyre do t'i testojë nxënësit në klasat e tyre para dhe pas periudhës së mësimdhënies. Pastaj ata do t'i krahasojnë rezultatet nga secila klasë.

Kështu, hulumtimi në veprim zë vend diku në mes të reflektimit individual të mësimdhënësit dhe hulumtimit edukativ formal. Ai u ofron mësimdhënësve mundësi për të reflektuar dhe për ta përmirësuar praktikën e tyre profesionale, si dhe ofron mundësi për bashkëpunim të mirë me kolegë.

9. Shembuj të hulumtimeve në veprim me EGRA-n

Ndikimi i leximit me zë në aftësimin e nxënësve të klasës së parë për lexim-kuptim, Luljeta Rama, Mitrovicë

Në këtë hulumtim në veprim, unë kam hulumtuar ndikimin që do të ketë leximi me zë në aftësimin e nxënësve për lexim-kuptim në klasën e parë. Leximin me zë e kam zgjedhur pasi është një nga strategjitë e leximit që do të ndihmojë lexim-kuptimin të gjithë nxënësit, por me fokus tek nxënësit që hasin në vështirësi. Leximi me zë ka të bëjë me angazhimin e nxënësve për të bashkëpunuar me mësuesin gjatë leximit, përmes pyetjeve të llojeve dhe niveleve të ndryshme, të cilat ndihmojnë që leximi të mësohet më lehtë dhe ajo që lexohet edhe të kuptohet. Hulumtimin e efektit të leximit me zë e kam kryer me gjashtë nxënës të klasës sime, përmes tri aktiviteteve, dy nëntesteve të testit EGRA, pyetësorit me prindër, vëzhgimit dhe komenteve të dy mësimdhënëseve dhe të dy prindërve të klasës. Mbledhja e të dhënave është realizuar brenda 5 javësh.

Kam zbuluar se leximi me zë ka efekt të mirë te nxënësit me vështirësi në lexim-kuptim, por edhe tek nxënësit e tjerë dhe tani leximi me zë ka vend të merituar në punë me klasën time. Si rezultat i këtij hulumtimi unë kam vendosur që të përdor Leximin me zë jo vetëm në fushën e gjuhës shqipe, por edhe në matematikë dhe në fusha të tjera mësimore.

Në periudhën përgatitore për punën me abetare kam hasur në nxënës që kanë vështirësi të dukshme në vetëdijen tingullore, e cila është hap i parë në lexim. Nga përvoja, kam vërejtur se nëse ky problem nuk trajtohet që në fillim, fëmijët do të kenë vështirësi edhe në klasë më të larta për të lexuar rrjedhshëm dhe për të kuptuar atë që lexojnë, jo vetëm në letërsi, por edhe në çdo fushë mësimore.


Për ta parandaluar një gjë të tillë vendosa ta bëj një hulumtim në veprim i cili përbëhej nga këta hapa:

1. Pyetësor për prindër për të parë se sa lexojnë ata bashkë me fëmijë;
2. Testimi i nxënësve përmes disa nëntesteve të A-EGRA-s;
3. Përpilimi i planit për punë me këta nxënës;
4. Zbatimi i planit;
5. Testimi i sërishëm për ta parë përparimin.

Pas pyetësorit me prindër dhe testimit të nxënësve kam ndërmarrë këta hapa:

- të zgjedh libra të përshtatshëm për përdorimin e teknikës së Leximit me zë, si p.sh. librat e punuar me nivele nga programi i BEP-it/USAID-it;
- të lexojmë së paku dy libra në javë brenda në klasë me teknikën e Leximit në zë;
- t’i informoj prindërit e nxënësve të testuar, për hapat e teknikës së Leximit me zë;
- të bisedoj me prindërit që edhe ata t’u lexojnë me zë fëmijëve në shtëpi së paku dy libra sipas dëshirës së fëmijës; dhe
- pas tri javësh të përsëris testimin për të vërtetuar nëse ka përmirësim në aftësinë e nxënësve për lexim-kuptim.

Tabela në vijim tregon rezultatet e nxënësve gjatë testimit të parë dhe të dytë.



Bashkëpunimi me bazë në shkollë, Sali Kuqi, Junik

Qëllimi i këtij hulumtimi është që përmes formave të ndryshme të bashkëpunimit të ndikohet në zhvillimin profesional të mësimitdhënësve për zhvillimin e shkathtësive të shkrim-leximit të nxënësve të klasës së dytë.

Njeriu për nga natyra e tij është hulumtues që vazhdimisht kërkon gjëra të reja dhe ndryshime. Në procesin mësimor ka mjaft probleme më të cilat mësimitdhënësi duhet të merret për zgjidhjen e tyre në mënyrë profesionale. Prandaj është shumë më rendësi bashkëpunimi i mësimitdhënësve për zhvillimin e tyre profesional dhe organizimin bashkëkohor të mësimitdhënies. Në procesin mësimor, përveç rezultateve, ka edhe mangësi, të cilat pastaj bëhen pengesë për arritjen e rezultateve të larta. Jo të gjithë nxënësit arrijnë rezultate të njëjta. Prandaj bashkëpunimi i mirëfilltë i mësimitdhënësve është shumë i rëndësishëm në gjetjen e strategjive, metodave, formave për tejkalimin e këtyre vështirësive të nxënësve të cilët kanë ngecje në mësim.

Detyrat e hulumtimit:

- Të identifikojmë llojet e vështirësive që nxënësit hasin në shkrim-lexim;
- Të praktikojmë së bashku me mësimitdhënësit strategji dhe teknika për ngritjen e shkathtësive të shkrim-leximit;
- Të zgjidhim situatat në klasë;
- Të përmirësojmë praktikat mësimore etj.

Në fillim është bërë përzgjedhja e nëntë nxënësve nga tri paralelet e klasave të dyta. Këta nëntë nxënës janë testuar duke i përdorur të gjitha nëntestet e EGRA-s.

Pasi testimi i nxënësve na ofroi një pasqyrë të qartë të vështirësive që nxënësit kanë në shkathtësitë e shkrim - leximit, së bashku me arsimtarët analizuam vështirësitë e nxënësve në secilin nëntest dhe caktuam planin e veprimit, si vijon:

Vështirësitë fonemike – Nxënësit nuk ishin në gjendje të bëjnë germëzimin e emrave, fjalëve, të krijojnë fjalë nga tingujt e ndryshëm, të veçojnë numrin e rrokjeve në fjalë etj.

Vendosëm që me këta nxënës të punohet me mësim plotësues, të punohet në mënyrë individuale dhe në grupe të vogla. Të përdoren fjali që rimojnë p.sh. shkolla, molla; Të organizohen lojëra me tinguj, të vazhdojmë me fjalë dhe aktivitete të tjera argëtuese, interesante dhe motivuese për nxënësit.

Vështirësitë fonetike – Nxënësit kanë vështirësi në përputhjen e tingujve dhe shkronjave, probleme në lexim dhe germëzim, probleme në deshifrim, vështirësi në fjalët që lexojnë etj.

Vendosëmtëpërdorenaktivitetetëlexim-shkrimitqëkërkojnëtëzbatojnënjohurifonetike, nxënësve t'u ofrohen fjalë të reja, arsimtarët të lexojnë çdo ditë. Të përdoren këto teknika: Leximi i përbashkët, Kartat meshkronja, Tabelat mexhepa, Kartat me fjalë të shpeshta etj. Vështirësi në rrjedhshmëri – Nxënësit kanë vështirësi në saktësi, shpejtësi dhe intonacion. Ata lexojnë pa emocione. Me nxënësit të bëhen ushtrime duke luajtur lojëra të ndryshme me gojë dhe me shkrim, të lexohet çdo ditë para klasës, të jepen përkufizim të fjalëve gjatë leximit. Të përdoren këto teknika mësimore: Lexim i përsëritur, Leximi me jehonë, Shokë leximi, Kartat me fjalët më të shpeshta etj.

Vështirësi në fjalor – Nxënësit kanë fjalor të dobët, nuk janë në gjendje të bëjnë lidhjen e fjalëve në tekste, të gjejnë fjalë të duhura për të përshkruar diçka.

Nxënësve t'u mësojmë fjalë të rëndësishme, të dobishme para se ta lexojnë tekstin. Lexoni para klasës çdo ditë dhe kur të hasni në fjalë të reja, ndaloni dhe jepni përkufizimin e tyre.

Të përdoren këto teknika mësimore: Kategorizimi i fjalëve, Harta e fjalëve, Leximi i përbashkët, Spektri i fjalëve, Rripat e fjalëve etj.

Vështirësi në të kuptuarit - Nxënësit fokusohen në aspekte dytësore gjatë leximit sa që ideja kryesore humbet. Nxënësit nuk dallojnë qartë vijueshmërinë logjike të ngjarjeve në tregim.

Nxënësve t'u bëhen pyetje të hapura, si: çfarë? përse? Sqaroni fjalët e reja gjatë leximit të tekstit. Nxënësit të nxiten të bëjnë përmbledhjen e asaj se çka kanë lexuar. Të përdoren këto teknika mësimore: Vizualizimi, Korniza e tregimit, Harta e fjalëve etj. Për mësimdhënësit mbetet sfida e madhe të shkruarit, pasi nxënësit kanë probleme fonemike dhe fonetike. Të shkruarit kërkon kohë, motivim dhe angazhim serioz gjatë punës ditore dhe asaj plotësuese. Të vazhdohet me ushtrime të shkrimit, si kopjim të shkrimit të shkronjave, rrokjeve, fjalëve, përshkrimin e ilustrimeve, lojërat me tinguj e shkronja, diktimin e më vonë edhe teknikat: Hamburgeri me paragraf, Mbajtja e ditarit, Të shkruarit e përbashkët etj.

Germëzimi i fjalëve te nxënësit e klasës së parë, Maliqe Mulolli-Jahmurataj dhe Zyla Osmani

Qëllimi i këtij hulumtimi është përmirësimi i germëzimit të nxënësit të klasave të para me ndihmën e aktiviteteve të larmishme mësimore që kanë ndikim direkt në përmirësimin e germëzimit.

Ne si mësuese të klasës, duke parë se nxënësit nuk kishin arritur të përvetësonin sa duhet germëzimin, ishim mjaft të shqetësuar dhe menduam gjatë për të gjetur një

zgjdhje dhe një metodologji apo qasje më ndryshe. Ajo që ne e pamë të arsyeshme ta provojmë ishte përdorimi i një numri të konsiderueshëm teknikash dhe aktiviteteve për të ndihmuar fëmijët në përvetësim e germëzimit. Të dhënat u grumbulluan pikërisht në klasat e para, me nxënës 5-6-7vjeçarë.

Në fillim rishikuar plan-programin në lëndën e gjuhës shqipe dhe menduar të futim aktivitete shtesë gjatë orëve të gjuhës shqipe për përmirësimin e germëzimit. Të gjithë nxënësit janë testuar me testin A-EGRA, ku kemi bërë përpilimin e një test të përbërë nga 20 fjalë. Dhjetë kanë qenë dyshkronjëshe dhe dhjetë trishkronjëshe.


Pastaj për pesë javë kemi punuar teknika, strategji, metoda të ndryshme të marra nga doracaku i A-EGRA-s.


Pasi kemi mbajtur testin me klasë dhe fillimisht kemi identifikuar gabimet në germëzim, atëherë kemi filluar me planin e parë të veprimit, gjegjësisht me përdorimin e teknikave dhe strategjive të larmishme për përmirësimin e germëzimit.

Ja disa nga teknikat e përdorura:

Germëzimi i emrit, Lojë germëzimi, Shiko dhe germëzo, Gjuha sekrete, Ktheje në gjuhën sekrete, Gjeje tingullin, Hiqe tingullin, Hiqe tingullin e emrit, Ndërro tingullin, Shto tingullin, Loja me kukulla, Qëllo tavolinën, Objekti i fshehur, Shpejt – ngadalë, Rimo me radhë, Ecim me fjalë, rrokje dhe fjali, Fjalët me rimë, Objekti i fshehur, Rimo me radhë, etj.

Pas pesë javësh, ne sërish i testuam nxënësit. Në vijim janë rezultatet nga testimi i parë dhe i dytë. Një gjë që vërejtëm është se, për të pasur rezultate më të mira, klasat me numër më të madh të nxënësve kanë nevojë për periudhë më të gjatë të intervenimit.





Ndikimi i leximit të shpejtë në të kuptuar, Adelina Metaj dhe Shemsije Shyti

Ky hulumtim kishte për qëllim të përcaktojë rëndësinë dhe ndikimin e leximit të shpejtë në të kuptuar te nxënësit e klasave të dyta, ndikimin e mësimdhënësit dhe prindit në këtë aspekt, në shkollën fillore në komunën e Istogut dhe të Mitrovicës. Po ashtu të nxitë te nxënësit dëshirën për të lexuar e pastaj për të kuptuar atë që lexohet duke zbatuar metoda ,ide, strategji, teknika të ndryshme. Pra plani ynë veprues është i bazuar në aktivitete të ndryshme, në literaturë dhe studime në lidhje me këtë rast. Në hulumtim janë përfshirë 10 prindër, 10 mësimdhënës të klasave të dyta dhe 10 nxënës të klasave të dyta të shkollave fillore. Si instrument për prindërit dhe mësimdhënësit janë përdorur pyetësorë gjysmë të strukturuar, pasi iu nënshtruan procesit të vlerësimit të besueshmërisë dhe validitetit (së pari janë plotësuar nga 3 pyetësorë me prindër dhe mësimdhënës që të shohim nëse janë të vlefshëm, pra nëse po marrim përgjigje në lidhje me pyetjen kërkimore). Me nxënësit u zhvillua test i drejtpërdrejtë. Analiza e të dhënave të fituara u realizua përmes analizës statistikore dhe analizës induktive.

Plani ynë ka përfshirë disa aktivitete të realizuara gjatë një muaji me nxënës, të cilat kanë dhënë rezultate të kënaqshme për nxënës, por mund t'i shfrytëzojnë dhe mësimdhënësit për punën e tyre. Rezultatet e dala treguan që në shkollën fillore të komunës së Istogut dhe të Mitrovicës, të lexuarit ka ndikim të madh në të kuptuar, sepse nxënësit që lexojnë rrjedhshëm kuptojnë atë që lexojnë. Teknologjia ende nuk perceptohet si një aset ndihmës në zhvillimin e shkathtësisë së leximit. Po ashtu, mësimdhënësit duhet të punojnë më shumë në lidhje me leximin, bashkëpunimin me prindër, por edhe prindërit duhet të jenë shembuj që fëmijët e tyre të lexojnë më mirë. Pastaj nxënësve u duhen ofruar tekste atraktive që ata vetë të zgjedhin e të lexojnë.

10. Standardet për vlerësimin e leximit në klasat e ulëta në gjuhën shqipe (A-EGRA)

10.1 Çka është Performancë Adekuatë?

A-EGRA është test i bazuar në kritere. Ne e vlerësojmë performancën në secilin nën-test kundruall qëllimeve të përcaktuara apo rezultateve që vlerësohen në secilin nën-test. Performanca adekuatë nënkupton arritjen e qëllimeve apo rezultateve.

Ne i morëm standardet e vendeve tjera jashtë Kosovës për të na ndihmuar ta përcaktojmë performancën adekuatë. Ato përfshinë standardet e testit DIBELS në SHBA. Megjithatë standardet e jashtme ishin në dispozicion për disa nën-teste – vetëdijen tingullore, leximin e fjalëve të pakuptimita dhe rrjedhshmërinë në lexim.

Gjithashtu i përdorëm edhe të dhënat nga testimi EGRA në Kosovë, i cili u bë me nxënës në fund të klasës së I-rë, dhe në mes e në fund të klasës së II-të. Nuk menduam se rezultatet e nivelit aktual të performancës përfaqësojnë performancën adekuatë. Në disa fusha – sidomos leximi i fjalëve fotografike, rrjedhshmëria në lexim dhe lexim-kuptimi – menduam se performanca aktuale është nën nivelin e dëshiruar. Kështu që normat u përcaktuan për t'i reflektuar synimet, si edhe performancën momentale. Po ashtu, aty ku menduam se ka vend për përmirësim, e shënuam në vijim.

10.2 Si vlerësohet performanca?

Kritere të ndryshme vlejné për nën-teste të ndryshme. Disa shkathtësi vlerësohen për saktësi, ndërsa shpejtësia nuk është e rëndësishme (p.sh. vetëdija tingullore); ndërsa për shkathtësitë tjera, shpejtësia është po aq e rëndësishme sa edhe saktësia (p.sh. rrjedhshmëria me zë); me fjalë tjera, niveli rritet me pjekurinë e lexuesit (p.sh. lexim-kuptimi). Në disa raste (p.sh. njohja e shkronjave, njohja e fjalëve fotografike), standardet janë "objektive". Në të tjerat (p.sh. rrjedhshmërinë, lexim-kuptimin) standardet reflektojnë këndvështrimin tonë për atë që është e mundshme, duke u bazuar në përvojën tonë.

Në mënyrë që t'iu ofrojmë mesimdhënësve udhëzime të qarta në lidhje me atë se kur duhet të intervenojmë dhe sidomos kur nuk duhet, performanca në nën-teste është e ndarë në tri nivele – "kënaqshëm", "mesatar" dhe "në rrezik". Këto tri nivele janë të përcaktuara si në vijim:

Niveli i shkathtësive	Definicioni	Rekomandimi
Kënaqshëm	Ka arritur nivelin e dëshiruar të shkathtësive për moshën dhe fazën e tyre.	Nuk nevojitet asnjë veprim
Mesatar	Nuk i ka të gjitha shkathtësitë, por është rrugës për t'i zhvilluar, me përkrahje.	Më shumë praktikë mund të jetë e nevojshme
Në rrezik	Nuk e ka nivelin minimal të domosdoshëm të shkathtësive, ka nevojë për ndihmë.	Konsulto pjesët relevante në Doracakun për lexim të BEP-it.

10.3 Standardet për Nën-testet momentale të EGRA-s

Nën-testet ndahen në tri pjesë kryesore, si në vijim:

- Shkathtësitë themelore (vetëdija tingullore dhe njohja e shkronjave/tingujve)
- Fjalori i fjalëve fotografike dhe dekodimi (leximi i fjalëve fotografike dhe leximi i jo-fjalëve)
- Rrjedhshmëria me zë dhe të kuptuarit (dëgjimi/leximi)

Dy nën-testet e para – vetëdija tingullore dhe njohja e shkronjës/tingullit – kryesisht synohen për nxënësit e klasës së parë. Performanca në leximin e fjalëve fotografike dhe leximi i jo-fjalëve duhet të zhvillohen gjatë klasës së parë, por rritet në numër dhe rrjedhshmëri gjatë klasës së dytë – dhe në disa raste edhe më tej. Shkathtësitë e rrjedhshmërisë dhe të kuptuarit (dëgjimi si edhe leximi) duhet të shfaqin zhvillim të dukshëm gjatë klasës së dytë, dhe vazhdojnë të zhvillohen gjatë shkollimit të nxënësit.

10.3.1 Vetëdija tingullore

Testi i vetëdijes tingullore përfshin ndarjen e fjalëve në tinguj. Pasi që ky nën-test i EGRA-s nuk matet me kohë, shpejtësia nuk është e rëndësishme, vetëm saktësia.

- Secili fëmijë duhet të ketë vetëdije tingullore – në fakt ta arrijë rezultatin e plotë – deri në fund të klasës së parë. Por, shpesh herë nxënësit do të bëjnë një ose dy gabime për shkak të stresit, edhe kur e zotërojnë shkathësinë.
- Nxënësit të cilët i ndajnë shumicën e fjalëve me saktësi, por megjithatë bëjnë disa gabime, me siguri janë rrugës për ta zotëruar. Numri i gabimeve që i bëjnë do të zvogëlohet me ushtrime – dhe ushtrimet mund të jenë krejt ajo për çka kanë nevojë nxënësit që janë në këtë fazë.
- Nëse një nxënës dështon në ndarjen e shumicës së fjalëve saktë, me siguri se ka problem më të thellë, dhe mund të ketë nevojë për ndihmë më të fokusuar nga mësimitdhënësi i tyre.

Prandaj, në çdo kohë nga fundi i klasës së parë e tutje, mësimitdhënësit këshillohen t'i zbatojnë udhëzimet në vijim për interpretimin e performancës në nën-testin e vetëdijes tingullore:

Performanca	Niveli i shkathësive
Gabime në 0, 1 apo 2 fjalë	Kënaqshëm
Gabime në 3 apo 4 fjalë	Mesatar
Gabime në 5 apo më shumë fjalë	Në rrezik

Të dhënat tona tregojnë se deri në fund të klasës së parë, së paku 80% të nxënësve janë në kategorinë e parë, dhe rreth 10% në secilën nga dy kategoritë tjera.

10.3.2 Njohuria e shkronjës/tingullit

Shkronja/tingulli duhet të njihen deri në fund të klasës së I-rë; por ka gjasa që nxënësit ende të bëjnë gabime në njohjen e tyre, sidomos në shkronjat me forma të ngjashme por orientim të ndryshëm, siç janë *b* dhe *d*. Kjo zakonisht nuk është shkak për brengosje.

Nxënësit duhet të jenë në gjendje t'i njohin shkronjat menjëherë, pa pasur nevojë të mendojnë apo kërkojnë në memorien e tyre. Prandaj, standardet në vijim janë shënuar sipas "shkronjave të lexuara saktë për minutë", në vend se thjesht "shkronjat e lexuara saktë".

Mësuesit këshillohen t'i zbatojnë udhëzimet në vijim për interpretimin e performancës në nën-testin për njohjen e shkronjës/tingullit:

Standardet për shkronja/tinguj – Shkronjat e lexuara saktë për minutë (ShLSM)

	Klasa 2 - Fund	Klasa 2 - Mes	Klasa 1 – Fund
Në rrezik	SHLSM < 30	SHLSM < 30	SHLSM < 25
Mesatar	30 ≤ SHLSM < 50	30 ≤ SHLSM < 50	25 ≤ SHLSM < 45
Kënaqshëm	SHLSM ≥ 50	SHLSM ≥ 50	SHLSM ≥ 45

Në Kosovë, vetëm disa nxënës janë në nivelin "mesatar" ose "në rrezik" në këtë nën-test. Çdo nxënës që bie në ndonjërin nga këto kategori ka nevojë për vëmendje urgjente.

10.3.3 Leximi i fjalëve fotografike (FSPM)

Fjalët në këtë nën-test janë marrë nga lista e fjalëve fotografike të BEP-it. Kjo listë quhet "Fjalori i fjalëve fotografike" sepse nxënësit duhet të jenë në gjendje t'i njohin fjalët pa pasur nevojë t'i dekodojnë. Nxënësi në klasën e I-rë apo II-të duhet të jetë në gjendje t'i lexojë fjalët të cilat janë në fjalorin e fjalëve të tyre fotografike, dhe atë së paku 60 fjalë për minutë. Fjala e cila nuk është në fjalorin e fjalëve fotografike duhet të dekodohet, gjë që e merr shumicën e kohës gjatë leximit. Shkalla e arritur varet nga numri i fjalëve të cilat janë në fjalorin e fjalëve fotografike të nxënësit.

Forma e publikuar e testit bazohet në listën e fjalëve fotografike për të dy klasat, I dhe II. Fjalët nga lista për klasën e II-të ka pak gjasa të jenë në listën e fjalorit të fjalëve fotografike për klasën I-rë, dhe fjalët nga gjysma e dytë e klasës së II-të ka pak gjasa të jenë në listën e fjalorit të fjalëve fotografike për mesin e klasës së II-të. Kjo është e reflektuar në standardet

e dhëna në vijim. Megjithatë, nuk ka arsye që një mësues të mos e shfrytëzojë listën e fjalorit të fjalëve fotografike të BEP-it për ta krijuar testin e tyre të fjalëve të cilat besojnë se janë në fjalorin fotografik të klasës së tyre – dhe në atë rast, standardet për fundin e klasës së II-të do të jenë më të përshtatshme për secilin nivel.

Standardet për leximin e fjalëve fotografike – Fjalët e lexuara saktë për minutë (FSPM)

	Klasa 2- Fund	Klasa 2- Mes	Klasa 1- Fund
Në rrezik	FSPM<40	FSPM<35	FSPM<30
Mesatar	40<= FSPM <60	35<= FSPM <50	30<= FSPM <40
Kënaqshëm	FSPM >= 60	FSPM >= 50	FSPM >= 40

Momentalisht, vetëm një e katërta e nxënësve që e kanë bërë testin kanë arritur në nivelin “kënaqshëm” të performancës, edhe pse rreth gjysma janë në nivelin “mesatar”. Shumica e nxënësve kanë nevojë për më shumë ushtrime me fjalorin e fjalëve fotografike, duke përdorur teknikat e rekomanduara në Doracakun e Leximit të BEP-it.

10.3.4 Leximi i jo-fjalëve (LJPM)

Dekodimi është shkathtësi shumë e rëndësishme, së bashku me fjalorin e fjalëve fotografike. Leximi i fjalëve të panjohura përfshin dekodimin e tyre. Nëse në një test përdoren fjalë të natyrshme, ekziston mundësia që nxënësit t’i kenë në fjalorin e tyre të fjalëve fotografike. Njohja fotografike ka tendencë të jetë më e shpejtë se dekodimi. Përdorimi i jo-fjalëve e shmang këtë problem.

Shkathtësia e dekodimit duhet të krijohet deri në fund të klasës së parë dhe në përgjithësi nuk zhvillohet shumë në mes të fundit të klasës së parë dhe fundit të klasës së dytë, përveç ndoshta në rastin e fjalëve shumë të gjata apo nxënësve “në rrezik”.

Standardet për leximin e saktë të jo-fjalëve për minutë (LJPM)

	End-Grade 2	Mid-Grade 2	End-Grade 1
Në rrezik	LJPM < 30	LJPM < 25	LJPM < 20
Mesatar	30 < LJPM < 50	25 < LJPM < 45	20 < LJPM < 40
Kënaqshëm	LJPM ≥ 50	LJPM ≥ 45	LJPM ≥ 40

Dëshmitë nga të dhënat e testit EGRA të BEP-it sugjerojnë se asnjë nxënës nuk ka mungesë të shkathtësive të dekodimit, por në përgjithësi rreth një në katër nxënës mund të ketë nevojë për më shumë ushtrime.

10.3.5 Rrjedhshmëria me zë dhe të Kuptuarit**10.3.5.1 Rrjedhshmëria me zë (FSPM)**

Leximi i rrjedhshëm është i domosdoshëm për të kuptuarit dhe leximi me zë është mënyra si e vlerësojnë mësuesit rrjedhshmërinë. Rrjedhshmëria me zë shprehet me anë të numrit të fjalëve të lexuara saktë për minutë (FSPM). Të dhënat e EGRA-s për fundin e klasës së II-të sugjerojnë se asnjë nxënës me nivelin e rrjedhshmërisë prej më pak se 80 FSPM arrin nivel të “kënaqshëm” të të kuptuarit – dhe çdo nxënës me rrjedhshmëri nën 60 FSPM gjendet në nivelin “në rrezik” në të kuptuar.

Rrjedhshmëria me zë duhet të rritet shumë shpejt me ushtrime, sidomos gjatë klasës së II-të. Tabela e standardeve në vijim reflekton këtë:

Standardet për rrjedhshmërinë në leximin me zë – fjalët e lexuara saktë për minutë (RrLZ)

	Fund-Klasa 2	Mes-Klasa 2	Fund-Klasa 1
Në rrezik	RrLZ < 60	RrLZ < 40	RrLZ < 20
Mesatar	60 < RrLZ < 80	40 < RrLZ < 60	20 < RrLZ < 40
Kënaqshëm	RrLZ ≥ 80	RrLZ ≥ 60	RrLZ ≥ 40

Shkathësitë e leximit me zë, për momentin në Kosovë, janë nën standardet ndërkombëtare – dhe ky deficit është më i madh në mesin e nxënësve me arritje më të mëdha. Prandaj, në përgjithësi nevojitet t’i kushtohet më shumë vëmendje përmirësimit të rrjedhshmërisë me zë.

10.3.5.2 Saktësia

Saktësia në leximin me zë është gjithashtu e rëndësishme sepse nxënësit të cilët bëjnë shumë gabime me siguri nuk e kuptojnë mirë atë që e lexojnë. Fleta e regjistrimit të testit të EGRA-s në letër nuk e përfshin matjen e saktësisë; por mësuesit mund ta llogarisin me lehtësi, ndërsa versioni në tabletë e ofron rezultatin e saktësisë.

Saktësia shprehet si përqindje e gabimeve të bëra – d.m.th. numri i gabimeve të bëra i pjesëtuar me numrin e përgjithshëm të fjalëve të lexuara (të dyja gjenden në fletën e rezultateve), të shumëzuar me 100. Për qëllim të interpretimit, saktësia definohet në tri nivele – i pavarur, udhëzues dhe i frustruar – si në vijim:

Niveli	Përqindja e fjalëve të lexuara saktë (FLS)	Implikimet
<i>Pavarur</i>	FLS \geq 95%	Nxënësi mund ta lexojë tekstin me lehtësi dhe kënaqësi
<i>Udhëzues</i>	90% < FLS < 95%	Nxënësi e sheh tekstin si sfidues, por mund të lexojë dhe ta kuptojë me pak ndihmë – prandaj edhe të nxënit ka rezultat.
<i>Frustrues</i>	FLS < 90%	Nxënësi mund të jetë aq i fokusuar në fjalë individuale sa që mund të mos kuptojë për çka bën fjalë teksti.

Mësuesit mund ta përdorin këtë rregull themelore për ta vlerësuar përshtatshmërinë e teksteve për lexim të cilat planifikojnë t’i përdorin. Nëse një nxënës ka rezultat të saktësisë nën 90%, atëherë mund të duhen tekste më të lehta në mënyrë që mësimdhënia të jetë e suksesshme.

10.3.5.3 Lexim-kuptimi

Testi i lexim-kuptimit e teston nxjerrjen e informatave të drejtpërdrejta, nënkuptimin dhe shfrytëzimin e njohurive paraprake për informim të interpretimit. Edhe në klasat e ulëta, lexuesit duhet t'i kenë dhe t'i shfrytëzojnë këto shkathtësi. Prandaj, ne propozojmë pikat në vijim:

- Nxënësi i cili përgjigjet saktë në të gjitha pyetjet, apo gabon vetëm në një, i posedon shkathtësitë e dëshiruara të të kuptuarit, dhe mund të konsiderohet lexues i kënaqshëm.
- Nxënësi i cili nuk përgjigjet në asnjë pyetje saktë apo vetëm në një pyetje, ka vetëm shkathtësitë elementare të të kuptuarit dhe ka nevojë për ndihmë.
- Nxënësi i cili përgjigjet në dy apo tri pyetje saktë posedon shkathtësi përtej nxjerrjes së informatave të drejtpërdrejta. Edhe pse nuk i kanë të gjitha shkathtësitë e dëshiruara, ata janë në rrugë të drejtë për t'i zhvilluar ato me përkrahje.

Pyetjet EGRA i synojnë nxënësit e klasës së dytë. Në rastin e klasës së I-rë, mund të jetë e përshtatshme t'i relaksoni paksa kriteret e nxënësve "kënaqshëm". Prandaj, propozohet klasifikimi i rezultateve në tri nivele, si në vijim:

Rezultatet e lexim kuptimit në nivele

Niveli	Klasa 2	Klasa 1-fund
Në rrezik	0 apo 1	0 apo 1
Mesatar	2 apo 3	2
Kënaqshëm	4 apo 5	3, 4 apo 5

Të dhënat që janë në dispozicion momentalisht tregojnë grupe pothuaj se të barabarta të nxënësve në secilën kategori; ekziston një grup i madh i lexuesve në nivelin "kënaqshëm", por edhe i lexuesve "në rrezik". Kjo sugjeron se nevojitet më shumë punë për shkathtësitë e "larta" të të kuptuarit.

10.3.6 Lexim-kuptimi

Klasifikimi i njëjtë i rezultateve në tri nivele sugjerohet edhe për dëgjim-kuptimin si për lexim-kuptimin:

Rezultatet e dëgjim-kuptimit në nivele

Niveli	Klasa 2	Klasa 1-fund
Në rrezik	0 apo 1	0 apo 1
Mesatar	2 apo 3	2
Kënaqshëm	4 apo 5	3, 4 apo 5

Të dhënat në dispozicion tregojnë proporcione kryesisht të larta të nxënësve në dy kategoritë e larta për dëgjim, në krahasim me lexim dhe proporcion shumë më të vogël në kategorinë “në rrezik”.

10.3.7 Diktimi

Diktimi e teston aftësinë e nxënësve në shkrim, germëzim dhe përdorim të saktë të gramatikës. Fjalja që lexohet përmban pesë gjëra kryesore leksike (katër emra dhe një folje); secila nga këto shënohet, së bashku me hapësirën në mes të fjalëve, radhën e fjalëve, shkronjën e parë të madhe dhe pikën në fund. Secila nga këto është shënuar me dy pikë, duke e bërë maksimumin prej 18 pikësh. Diktimi padyshim nuk është i bazuar në kritere; dhe rezultatet kanë tendencë të jenë të larta. Prandaj, standardet në vijim janë të bazuara kryesisht në performancën aktuale:

Rezultatet e diktimit në nivele

Niveli	Klasa 2	Klasa 1-fund
Në rrezik	Total < 8	Total < 6
Mesatar	8 ≤ Total < 15	6 ≤ Total < 12
Kënaqshëm	Total ≥ 15	Total ≥ 12

Interpretimi i rezultateve mund të jetë proces prej dy fazash. Së pari, rezultati i përgjithshëm mund të përdoret për t’i identifikuar nxënësit “në rrezik”. Së dyti, mësuesit mund të përdorin gjëra ku rezultati i nxënësit “në rrezik” është një ose zero për t’i identifikuar fushat ku nevojitet vëmendje.

